

Ju lutem mos qeshni!

BIBLIOTEKA
SHTETIT

BJH-7
T 95



SADIK TROÇI

814-2
T 93

SADIK TROÇI

Ju lutem, mos qeshni!

tregime humoristike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KUR NUK KE NUHATJE, MOS MERR ZOTIME

Ishte një pasdreke. Unë kthehesha nga stadiumi. Për shkak të fitores së skuadrës sime, kisha hedhur krahëve xhaketën që ishte ca e grisur dhe më vinte zor ta vishja. E pata hedhur dhe e gjeta vetëm kur mbaroi loja. Por edhe pse e gjeta, sa para bën, bashkë me lojën edhe xhaketa kishte mbaruar. Më mirë të mos e kisha gjetur fare se sa e gjeta në atë gjendje. Tifozat e kishin copëtuar sikur ta kishin ngrënë me dhëmbë.

Te shkallët e apartamentit gjeta Eftiminë, njerën nga anëtarët e kryesisë së frontit në lagje.

— Mirë mbrëma, Velo! — Më përshëndeti ajo.

— Mirë mbrëma! — Ju përgjigja unë shumë serioz por i gëzuar.

— Po kthehesh nga sporti ë?

— Ja, siç e sheh, po pse më pyet?

— Se nuk të gjejmë në shtëpi ditët e diela.

— E përse më kërkuat?

— Oj, pse të kërkuam? Pse pyetje është kjo?

Po në punët shoqërore, po në punën vullnetare, po në problemet e frontit kush duhet të vijë? Mos ja ke lënë gruas të gjitha problemet? Të paktën në pu-

nën vullnetare të vije vetë ose së fundi të dy, po jo vetëm gruaja.

— Ehu ha! Moj shoqja... (nuk ja mbaja mend emrin) moj shoqja e kryesisë. Pse, a pak e keni gruan në punët shoqërore, që më kërkoni edhe mua? Ju na keni ngrënë veshët me emancipimin. Ja u emancipuat, i morët të gjitha frenat në dorë. Tani çfarë doni?

— Oj, oj, oj! — Psherëtiu ajo. — Sikur të gjithë burrat njëlloj janë. Të tërë njëlloj flasin. — Shtoi pas pak. Tundi kokën ca dhe më foli:

— Rina jote ka vënë treqind e pesëdhjetë tulla në skelat e ustallarëve deri tani, kurse ti...

— Hahahah! — Qesha me të madhe, ndofta edhe pa dashje.

— Pse qesh? Ja ta thotë Eftimia, se kështu ju burrat nuk po... — Ma ktheu ajo duke më treguar edhe emrin.

— Qesh se gruaja ime — ja ktheva unë — paska ngjitur vetëm treqind e pesëdhjetë tulla në skelat e muratorëve, po a e di sa jam lodhur unë?

— Pse, çfarë ke bërë ti që je lodhur?

— Kam mbajtur tremijë e pesëqind burra në krahë për dy orë rrjesht atje në stadium.

Ndofta do ta kishim zgjatur edhe më fjalën me Eftiminë, por erdhi Rina.

— Hë more Velo! Shyqyr që paske ardhur! Po vetë erdhe shëndoshë? Pa xhaketa, ëhë, na e paska marrë të keqen!

— E po fitorja, moj Rina, fitorja i ka këto.

— Nejse. Nuk më duhet shumë të di se ku e grise, por tani zgjidh: a do të ngjitesh në pallat të shikosh e të rregullosh gjellën e darkës, apo do të shkosh të hedhësh tulla në skela?

— Te cili pallat jeni? — Pyeta unë.

— Tek ai pallati me tulla të bardha, atje në fund të lagjes.

— Ca larg i uruari. Më mirë po ngjitem në apartament e po...

— Atëhere shiko gjellën, fërgoje dhe hidhi salcën, hidhi gjethe dafine dhe, kur ta shohësh se është pjekur mirë mishi, hiqe nga zjarri. E bën dot këtë?

— Si jo, moj Rina, po...

— Çfarë? — Pyeti Rina ca e habitur.

— Zjarrin e ke ndezur?

— Po. Por shikoje ndonjëherë se mund të shuhet.

— Mos u bëj merak fare për këtë.

— Atëhere mirë të gjetsha! — Foli Rina dhe së bashku me Eftiminë u nisën për në pallatin ku bëhej puna vullnetare.

— Mirë ardhsh, e dashur, kujdes e mos u vono shumë, se unë as drekë nuk kam ngrënë dhe nuk kam për të ngrënë derisa të kthehesh edhe ti.

Ato tundën duart dhe u larguan.

Kur hyra në shtëpi, të parën punë që fillova të bëja ishte zbatimi i porosive të Rinës.

Kontrollova furrën ku ndodhej tava me mish e patate. Asaj pothuajse i kishte ardhur koha që unë t'i hidhja salcën dhe gjethet e dafinës (sipas mendimit tim). Pasi e fërgova ca salcën, ja hodha tavës dhe e vura përsëri në furrë. Pastaj shkova te rafti i bufesë.

E hapa, por sesi shtanga në vend. Nëpër të dhjeta qeskat e politilenit kishte gjithfarë llojë bimësh e gjethesh aromatike.

Po cila prej tyre duhet të ishte gjethja e dafinës?



U mendova ca. I shikova me vërejtje, i nuhata por jo. Asnjërën prej tyre nuk mund ta quaja se ishte gjethë dafine. Pas pak u kujtova:

«Po mirë de — thashë me vete — në këtë magazinë gjethesh e bimësh a nuk do të jetë edhe gje-

thja e dafinës? Sigurisht që po. Rina nuk besoj të gabojë. Atëhere, për të qenë brenda rregullave e për të çuar deri në vend zotimin që mora para asaj shoqes së kryesisë dhe Rinës, po i hedh tavës nga pak prej të gjitha këtyre gjethëve që janë nëpër qeska».

Mora vendim të menjëhershëm. Në këto raste duhet të jeshë edhe ca praktik. Bërtita me të madhe:

— E gjeta, e gjeta!

Menjëherë veprova. Hapa qeskat dhe mora nga një dorë me gjethë prej të gjithave e i futa në tavë. Kur i kisha hequr nga sirtari të gjitha qeskat e plastmasit me gjithë gjethë, poshtë tyre vura re nja dhjetë gjethë të veçuara që kishin një erë më të këndshme se ato që i hodha tavës më parë. Këto gjethet e veçanta ma prishën mendjen dhe thashë: «Ah, ç'gabim kam bërë! Me siguri këto janë gjethet e dafinës.»

T'i hiqja ato që kisha hedhur në tavë, nuk kisha mundësi, atëhere çfarë më mbeti të bëja? Por, për t'i shpëtuar qortimit të Rinës se gjoja nuk kisha ditur t'i gjeja gjethet e dafinës e isha ngatërruar me ato të tjerat dhe që të dominonin këto, që i gjeta ca me vonesë, vendosa t'i hidhja të gjitha sa qenë aty.

I sigurtë se kisha kryer çdo porosi të Rinës, u rehatova. Prisja Rinën të vinte nga puna vullnetare dhe tavën të piqej. Ama uria filloi të më jepte sinjal.

Ndeza një cigare. Nga furra e sobës filloi të dilte një erë e këndshme mishi të pjekur dhe lloj, lloj erërash dhe aromash. «Ah, të uruara aroma e erëra! Ç'më punuat!» Filluan të më ngacmonin shqisat e nuhatjes dhe të shijes. Goja filloi të më lëshonte një lloj lëngu të përzier me aromën që vinte nga furra. Unë e përcillja atë lëngun që më lëshonte goja me një shije të madhe. Nuk munda të prisja më. Megjithëse

mishi ende nuk ishte pjekur plotësisht, vendosa të haja ca prej tij ashtu si ishte. Mora ca. Hëngra. Mora prapë dhe hëngra. Shumë i shijshëm ishte i gjori. Mora përsëri dhe e hëngra edhe atë. Ma kishte ënda të haja më shumë patatet dhe zarzavatet e tjera me aroma se sa mishin që ende nuk ishte pjekur mirë e nuk shqitej kollaj. Pasi e shova ca atë urinë e madhe që kisha, i futa dhe dru sobës, pastaj mbusha edhe një gotë me raki dhe herë pas here merrja nga një thelë mishi duke e zgjedhur atje ku ishte më i pjekur.

Koka filloi të më rëndohej, m'u duk se filloi të më zinte rakia. Qepallat e syve m'u rënduan aq, sa unë nuk isha më i zoti as t'i ngrija lart, as t'i lëvizja fare.

U shtriva në divan dhe mendova se do të bëja gjumin më të rehatshëm.

Rina ishte kthyer nga puna vullnetare ca me vonesë. Që në hyrje të apartamentit kishte dëgjuar erën e djegur të tavës. Kur e kishte hequr nga furra, ishte e kotë, sepse tava që djegur e bërë shkumb.

«Ç'ke bërë kështu, more Velo?» — Kishte bërë titur ajo, por unë nuk i kisha dhënë asnjë përgjigje. Pastaj, kur kishte parë që unë e kisha lënë përgjysmë gotën e rakisë (gjë e cila nuk kishte ndodhur ndonjëherë me mua) dhe mishin e përgjysmuar në pjatë, ishte kujtuar se do të isha dehur. Ishte munduar e gjora të më zgjonte por çdo gjë kishte qenë e kotë.

Pak më vonë kishte vënë re atë zbehjen time në fytyrë dhe kishte lajmëruar menjëherë mjekun.

Ai kishte ardhur shumë shpejt. Kur më kishte vizituar dhe më kishte matur tensionin, edhe mjeku ishte alarmuar ca dhe kishte dyshuar për një helmatisje nga ndonjë ushqim.

Më kishin shtruar në spital.

Se çfarë më kanë bërë gjatë kohës që isha në atë gjendje nuk di por, kur u përmenda pas dy ditësh dhe e pashë veten të rrethuar nga gjithë ata njerëz në krevat, u habita. As në ëndërr nuk e kisha parë këtë gjë, megjithëse kisha bërë nja dy ditë gjumë. Anësh ishin gjithë të afërmit, nëna dhe Rina. Desh u çmenda kur e pashë veten në atë gjendje. Nuk dija e nuk mbaja mend se çfarë kishte ndodhur me mua.

Nëna foli:

— Ore birçe! Ç'deshe që i fute gjellës gjethin e hashashit, që e kam pasë ruejtë ndën qeskat e plastmasit që ta pija kur nuk kisha gjumë? Kur nuk di t'i nuhasësh aromat e as t'i njohësh bimët, mos merr zotim kot se...

«Edhe këtë herë që desha ta ndihmoja Rinën — mendova unë — paskam vënë veten në gjumë e Rinën në hall. Pa lëre po e paskam lënë pa bukë fare!»

TE STANI I LEPUJVE

Një herë na erdhi në kooperativë shefi i bujqësisë. Ishte mjaft i dhënë pas gjuetisë. I kishin thënë se në Bukas ka mjaft lepuj. Për këtë i kishin treguar të drejtën.

— Ku do të vemë nesër për lepuj? — I kishte thënë kryetarit.

— Te stani i lepujve. — Ishte përgjigjur kryetari.

— Si? Paskeni bërë stan me lepuj — e kishte pyetur i habitur shefi.

— Jo, ore, jo. Por kemi ca stane atje në Bukas; gjahtarët ua kanë vënë emrin «stanet e lepujve».

— Hahahaha — qe gajasur shefi — dhe unë kujtova se keni ngritur stan me lepuj.

Të nesërmen kryetari i kooperativës së bashku me shefin e bujqësisë kishin shkuar për gjueti tek arat në Bukas, kishin zënë pritë në stanin e lepujve dhe prisnin gjahun. I pari e kishte parë lepurin shefi i bujqësisë, e kishte gjuajtur dhe lepurit kishte filluar të rrokullisej nëpër ara. Shefi vrapoi. Lepuri shkoi e zbriti në një mezhde me ferra dhe ashtu i plagosur u rrokullis nëpër arë derisa zbriti në ferrë. Shefi i qe vënë pas por nuk kish mundur të hidhej

nga mezhda. Sa të bukura e të larta ishin atëhere ato! Kur e pa të zorshme zbritjen, (për t'u ngjitur nuk mundej fare) ju kthye kryetarit:

— Mendoni se do të vijë traktori këtej ndonjë ditë?

— Po.


— Atëhere pse nuk i prishni këto mezhda me kumri e ferra? Apo kujtoni se është lepur traktori? Veç kësaj shikoni sa tokë keni lënë pasdore. Qysh si-vjet t'i prishni!

Sa u afrua pranvera dhe u korr gruri, kryetari urdhëroi të prisheshin mezhdat dhe të hiqeshin ferrishtet që kishin zënë rrënjë dhe kishin krijuar atë tarracën shumëvjeçare. Në fillim na u duk se me gjithë mend bëmë një punë shumë të mirë duke shtuar sipërfaqen e tokës e duke i bashkuar arat Bukasit, por më vonë e kuptuam gabimin:

Disa vjet më vonë, kur mezhdat ishin prishur, nga tokat e Bukasit morëm prodhime shumë të pakëta. Kështu që, për vitet pasardhëse, për arat e Bukasit nuk planifikuam fare prodhime, bile u tha se ishin të papërshtatshme për asnjë kulturë bujqësore. Dikush, sigurisht ndonjëri nga ata të kryesisë, — tha se tokat e Bukasit ishin shterpëzuar ose më mirë të themi u konsideruan si toka që kishin humbur pjellorinë për çdo lloj kulture që kultivohet në rrethin tonë. Kështu që, prej asaj kohe ara e Bukasit u la djerrë e nëpër të përsëri filluan të kullosin lepujt. Por këtë herë diçka më lirisht se asnjëri nuk kujdesej t'i ruante e t'i gjuante lepujt.

Deri këtu ishte një e keqe, por më vonë arës së Bukasit ju shtuan telashe më të mëdha:

Para nja pesë vjetësh u krijua dhe kooperativa malore e Thanësit (kështu quhet fshati që ndodhet



në kufi me arën e Bukasit). Ata me t'u bërë kooperativë, i hynë punës për të bërë rrugën automobilistike dhe u lidhën me komunikacionin kombëtar. Kjo qe një punë e mirë për ata, por neve na dëmtoi ca. Rruga u ndërtua tamëm mbi arën tonë. Ca gurë i hodhën minat, të tjerë u rrukullisën gjatë punës dhe arat u mbushën plot e përplot. Me një fjalë u kthyen në gurishte. Hallall kjo, por ata të kooperativës së Thanësit, duke mos i dhënë rëndësi tokës që kishin nën rrugë, ndërtuan nja dy nënkalime uji mu mbi arën tonë. Kështu gjithë ujrat e rrugës filluen të zbrisnin nëpër arën tonë dhe qysh vitin e parë e ndanë në tri katër pjesë të ndryshme.

Që prej asaj kohe vetëm emri i tyre mbahej mend, ndërsa vetë ara i ngjiste një toke të braktisur, ose siç i quan kadastra u emërtuan «toka të abandonueme». Bile edhe nga kadastra u shregjistrua.

Por më vonë me bashkimin e kooperativës, edhe për arat e Bukasit erdhën kohë të tjera.

Para dy vjetësh kooperativa jonë u bashkua me Thanësin. Si kooperativë më e madhe që u bëmë na sollën edhe një agronom të lartë. Ai kishte mjaft përvojë jo vetëm si agronom por edhe për mbrojtjen e tokave nga erozioni, për të ruajtur atyre pjellorinë e tokës. Një natë kryeagronomi na mblodhi në vatrën e Kulturës dhe na bëri një leksion për ruajtjen e pjellorisë së tokës.

— Një nga arësyet kryesore të ruajtjes së pjellorisë është mbrojtja e tokës nga shpëlarja e kriprave. Pra — vazhdoi Kryeagronomi duhet ulur pjerrësia e tokave me çdo kusht. Për këtë në shumë toka të fshatit tonë — vijoi ai — është i domosdoshëm tarracimi ose siç i keni quajtur më parë ju mezhdat...

Të moshuarit shikuan njëri tjetrin në sy.

— Si? — Ja ndërpreu fjalën Kryeagronomit xhaxha Misimi. — U dashkan ba tarracime? Ë? Ato mezhdat që banim dikur ne?

— Po — vazhdoi agronomi.

— Prandaj na paskan dalë nga dora arat e Bukasit te stani i lepujve. — Folën shumica e kooperativeve. Qetësia u prish, disa donin t'ja hidhnin fajin kryetarit, disa të tjerë shefit të bujqësisë.

Që të nesërmen agronomi me një pjesë të kooperativeve vrapuan në Bukas. Me ne erdhën edhe dy mësuesit e shkollës. Mblodhëm gurët që ishin nëpër arë dhe krijuam përsëri tarracat. Disa të tjerë bënë një kanal në krye të arës, larguan ato ujërat e rrugës që kishin krijuar dy si përrenj të vegjël nëpër arë. Tridhjetë pendë qe punuan atë ditë. Gjatë punës agronomi mori ca dhé nga thellësia e tokës dhe bashkë me mësuesin e kimisë dolën në anë të arës. Hapën një kuti dhe filluan e se ç'po punonin; ne u afruam e i pyetëm:

— Ç'po bëni?

— Po i bëjmë ca analiza tokës, — thanë ata.

— Si? — Pyetëm ne të habitur — ju bëkan tokës analiza?

— Po — tha mësuesi — kjo tokë ka nevojë për nitrat.

Që atë vit e mbollëm dhe, kur e korrëm grurët e arës te stani i lepujve, u habitën të gjithë, mund të them se u muar aq grurë, sa mjaftoi që kooperative të hante dy muaj bukë.

Kooperativistët e uruan agronomin:

— Rrofsh, more agronom, ti na qenke për tokat tona, se ai... .. qe duke na i kthyer arat në kall-drame.

— Edhe ujërat e tepërta e prishin, prandaj duhen

languar me kanale e vija sipas terrenit që paraqitet, në mënyrë që mos t'i heqë kripën — vazhdonte agronomi — se toka ka shumë nevojë për kripëra.

E morëm vesh se edhe toka e dashka kripën, por nuk e dinim se mezhda ja ruan. Kot nuk kemi thënë «Çdo gjë me kripë e kripa me karar». Po ç't'i bëjmë atij kryetarit që paska qenë i pakripë për vete e na nxori edhe kripën e arës.

DITËLINDJA E GJYSHIT

Dasmë e madhe
te lalë Kamberi

(Popullore tiranase)

Deri para nja katër a pesë vjetësh gjyshi im dhe vërsnikët e tij nuk e patën festuan ndonjëherë ditëlindjen e tyre, por këto vitet e fundit gjyshi dhe disa të tjerë vërsnikë të tij filluan ta festojnë. Kjo gjë bëri shumë bujë në gjithë krahinën tonë. Ne u kënaqëm së tepërmi kur pamë se edhe gjyshërit po hiqnin dorë nga festat fetare dhe po festonin vetëm festat zyrtare dhe ditët e shënuara familjare.

Vitin që shkoi dhe vjetët e tjerë i festuam mirë, por pa ndonjë përgatitje të veçantë. Ndërsa sivjet, meqë gjyshi mbush tetëdhjetë vjeç, ndërsa gjyshja shtatëdhjetë e pesë, ne menduam dhe vendosëm që këtë përvjetor ta festonim jo si zakonisht, por me një ceremoni të vërtetë. Një gjë duhet thënë: «Deri sivjet ne nuk i patëm shënuar gjëkund ditëlindjen e gjyshit ose të gjyshes». Disa herë i kishim vënë në diskutim datat që gjyshi e gjyshja kishin të shënuara në letrat e njoftimeve të tyre, bile deshëm t'i

skalishim në rrasat e oxhakut, por dëshira e gjyshit sikur nuk plotësohet tamëm, prandaj rreth kësaj date u bënë shumë diskutime nga të gjithë në pjesëtarët e familjes sonë, e cila përbëhet prej nëntëdhjetë e gjashtë pjesëtarësh, flas për atë familje ku si kryetar konsiderojmë gjyshin, ndërsa me xhaxhallarët, me hallat, me djemtë dhe gocat e hallave dhe të xhaxhallarëve, me burrat e nusët si dhe me fëmijët e tyre, në krijojmë një lagje më vete, po të jetonim në të njëjtin vend. Sa për dijeni duhet shënuar se jemi tridhjetë e gjashtë fëmijë me njëqind e tetëdhjetë anëtarë. Ndërsa si anëtarë familjeje me gjininë e gjyshit jemi vetëm nëntëdhjetë e gjashtë, duke lënë mënjënë ata që përbëjnë vëllezërit dhe motrat e gjyshit dhe të gjyshes. Pra dita dhe ora e saktë e lindjes së gjyshit dhe të gjyshes mbeti të diskutohet në ndonjë sesion shkencor familjar sepse asnjëri nga ne nuk mundi të jepte ndonjë mendim të saktë me argumenta bindës. Në një bisedë të shtruar (kjo zëvendëson shumë mirë simpoziumin) që patëm vjet, gjyshi mbajti këtë kumtesë:

— Me qenë se familja jonë ka shumë nipa dhe mbesa, vëllezën e halla e ku ta di unë, këta të gjithë bajnë një numër të madh. Mendoj se nuk asht e udhës dhe shumë e nevojshme të festojmë të gjitha ditëlindjet sepse një gja e tillë do të na linte gjithë kohën pa punë tue u marrë vetëm me festimin e ditëlindjeve të anëtarëve të familjes, por si festë e përbashkët e familjes sonë të mbeten vetëm ditëlindja ime dhe e gjyshes suaj, e cila ka lindur pesë vjet e dy muaj e disa ditë më pas meje (gjyshen e quajnë Aishe, por gjyshi ende e ka të zorshme t'ja zërë emrin me gojë). — Pra — vazhdoi të fliste ai — ne do të mblidhemi dy herë në vit, radhën e parë për mue dhe të dytën

20767

~~5/11/44~~

për gjyshen tuej. Ditëlindjen time ta quejmë festën e madhe të përvjetorit, ndërsa të gjyshes ta quejmë festën e vogël të përvjetorit, këto ditë bien dy muej e dhjetë ditë larg nga njana-tjetra. Dakord? — shtoi ai në fund të fjalës së tij.

— Dakooooord! — Folëm ne të gjithë njëzëri si në kor. Në këtë moment gjyshit i shkoi mendja te predikimi që bënte dikur në xhaminë e fshatit dhe xhemati (ata që faleshin) i mbanin ison e lutjeve që lëciste ai me librin e së falmes në dorë.

Kështu, ne të gjithë që ishim të kalemit shënuam nëpër fletoret tona të shënimeve datat e lindjes të gjyshit dhe të gjyshes (Ajo dy muaj e dhjetë ditë më vonë).

Kaluan njëmbëdhjetë muaj e ca dhe ne ishim bërë gati të gjithë: nipërit, mbesat, nuset e ku di unë tani t'i numroj me soj e sorollop. Ato ditë që ne i kishim të shënuara i prisnim me padurimin më të madh. Që të mos u blinim të gjithë të njëjtat dhurata, bëmë një mbledhje në veçanti dhe hodhëm shortin për secilin, këtë e bëmë që gjyshi dhe gjyshja të merrnin dhurata nga më të ndryshmet. Mua më takoi t'i blija një llullë gjyshit dhe ngjyrë flokësh gjyshes. Kisha bërë plane që këto t'i blija të paktën nja dhjetë ditë përpara asaj që unë kisha të shënuar në kalendarin e zyrës dhe të xhepit. Kjo ditë, që për mua dhe për të gjithë ne ishte ditë e shënuar, binte njëmbëdhjetë ditë më vonë, por tamëm atë ditë mua postieri më solli një telegram me këtë përmbajtje: «Nesër kemi ditëlindjen e gjyshit pikë, të presim të vish patjetër pikë, baba».

Lajmi më ra si bombë dhe më habiti, menjëherë rashë në mendime. «Vitin e kaluar gjyshi e pati ditëlindjen dhjetë ditë më vonë, po sivjet pse të ketë

ndryshuar? Ndofta do ta kem gabim unë, pa ta shoh një herë shënimin se mos ndoshta me gjithë mend kam gabuar?» — mendova me vete. Ashtu ishte, gjyshi e kishte ditëlindjen dhjetë ditë më vonë se ajo që thuhej në telegram. Tani u ngatërrua më keq puna. Si të jetë e mundun? Dhe nisa ta vrisja mendjen për lloj-lloj gjërash që mund të kishin ndodhur andej nga njerëzit e mi që kemi në fshat. Por për fat mendimet e mia m'i ndërpreu zilja e telefonit. E mora pak me përtesë.

— Urdhëro! — U përgjigja unë.

— Dua pak shokun Kaso. — Foli ai që më kërkonte.

— Unë jam, kush më kërkon, ju lutem?

— Selaudini jam, vëlla, si je?

— Aman, Selo, mirë bëre që më dole në telefon se isha në hall të madh. Kam marrë një telegram dhe nuk po di si është puna. Tani kisha ndër mend të të merrja unë ty. Po sa mirë që më dole mu në grykë të çiftes!

— Pse, more hallezi, çfarë ke kështu? — Më pyeti byrazeri dhe pa pritur që t'i jepja shpjegimin, ma ndërpreu: — Do të keshë marrë edhe ti telegram për ditëlindjen e gjyshit? Ky është halli yt? Mos u mërzit se, për nder, unë e kisha harruar, por duhet falenderuar babai që më mori në telefon. Seriozisht do të isha turpëruar fare. Unë e bleva qeleshen e bardhë për gjyshin, po ti, ja bleve atë që të kemi caktuar? Në mos gabo, ty të ka takuar t'i blesh një llullë. Në qoftë se nuk ka aty, po ja blej unë, se ka plot këtu në dyqanet tona. Nejse, nesër po të pres tek ura, të vish me autobusin e pasdites — shtoi ai.

— Kollaj është puna e llullës, po mua më çudit një gjë — ja ktheva unë i bindur se byrazeri nuk

kishte qenë i rregullt dhe nuk i kishte shënuar në kalendarin apo në bllokun e tij ditëlindjen e gjyshit dhe të gjyshes.

— Çfarë? — Më pyeti ai i shqetësuar.

— Vitin që kaloi ditëlindja e gjyshit ka rënë dhjetë ditë më vonë.

— Do ta kesh gabim. — Ma ktheu byrazieri.

— Unë mund të gaboja, po të mos e kisha shënuar në kalendarin tim. Pra lapsi nuk besoj të ketë gabuar, dhe nuk është e mundur të ketë ndodhur një gjë e tillë, pasi unë jam i rregullt në mbajtjen e shënimeve, sidomos të datave dhe orëve të shënuara që nevojiten për të tilla raste. Ti e di sa i rregullt jam unë në këto pika.

— Atëhere do të ketë ndodhur ndonjë fatkeqësi dhe nuk duan të na tregojnë por na thërrasin gjoja për ditëlindjen e gjyshit. — Shtoi byrazieri me të shpejtë duke rënë edhe ai në dyshime. Mua kjo fjalë më shqetësoi më tepër. Dy net më parë kisha parë edhe ëndrra të këqia, megjithëse nuk u besoj atyre. Por këtë herë thashë se ndofta me gjithë mend diç do të kishte ndodhur.

— Si t'ja bëjmë? — Ja ktheva unë i penduar pse i thashë të gjitha këto gjëra dhe e bëra merak edhe byrazierin; së paku le të merakosesha vetëm unë.

— Po të pres, të vish sa më parë! Bëj çfarë të duash për maqinë dhe hajde! Ndërkohë unë po interesohe më t'i telefonoj ndonjërit nga të kryesisë së kooperativës, ata me siguri diç do të dinë — shtoi byrazieri dhe e mbylli telefonin.

Unë nuk e zgjata më tepër por dola jashtë dhe u interesova e gjeta një automjet të rastit.

Derisa shkova në lokalitet, ku punon byrazieri im, isha me gjak të ngrirë. Kurrë nuk më mbushej

mendja se me gjithë mend nuk do të kishte ndodhur ndonjë e keqe te njerëzit që kemi në fshat. Kur pashe byrazerin që po qeshte, e mora veten disi.

— Hë, si është puna? — Pyeta unë.

— Ditëlindja e gjyshit — ma ktheu Selaudini.

— Me cilin bisedove?

— Me kryetarin e kooperativës, edhe ai është i thirrur në darkën e tetëdhjetëvjetorit të gjyshit.

— Paska për ta bërë fora sivjet. — Ja ktheva unë.

— Lëre mos e pyet, kushëriri që punon në shtëpinë e kulturës na paska thirrur edhe orkestrën me gjithë trupën që ka shtëpia e kulturës. Na vaftë mbarë pra, or byrazer, e dalshim faqebardhë!

Në dhomën e pritjes nuk kishe ku të hidhje as kokrrën e mollës. Në anë të vatrës ose më mirë të them në qoshe kishte zënë vend gjyshi. Ata që vinin e uronin: «Me gëzim, or Bajram!» — Dhe gjyshi u përgjegjej: «Gëzim paçi, or bijt e Bajramit, gëzime paçi!»

Disa të tjerë: «Pleqëri të mbarë, baba Bajram e për shumë vjet gëzuar!» — Dhe gjyshi u përgjegjej: «Ju falem nderit, me gëzime u plakshi edhe ju, bijt e Bajramit!» Të gjithë i dorëzonin dhuratat dhe gjyshi, pasi i shikonte, i peshonte me dorë dhe me interes për të caktuar çmimet sipas mendjes së tij, nganjëherë ua tregonte dhe të tjerëve dhe i krahasonte me njëra-tjetrën, pastaj i vendoste në kasën sekrete që ka ai në anë të oxhakut (andej nga rri vetë). Në këtë kasë ai dikur mbante librat që duhej të kishte si hoxhë duke filluar që nga kurani dhe libri i së falmes si dhe veglat e kafes. Atëhere nuk ja lëshonte ndokujt çelësin në dorë. Çelësin e kësaj kase dhe sot e ruan me shumë korrektesë. Bile kjo na bën për-

shtypje të madhe neve të tjerëve: pse gjyshi ta ruajë me kaq korrektesë tani që librat i ka dorëzuar?

Festa po përgatitej që të shkonte të nesërmen çdo gjë për mrekulli. Ne kishim dëshirë të shtronim dhe raki, por gjyshi në këtë pikë nuk qe dakord. Jo se ai nuk e pi rakinë, tani ai e pi më shumë nga ne, por sonte nuk e di pse nuk ja ka qejfi ta festojë tetëdhjetëvjetorin e tij me raki. Gëzimi ynë ishte i papërshkrueshëm jo se na u bë gjyshi tetëdhjetë vjeç, por sepse të gjithë jemi të bindur se edhe gjyshi jonë, që është më i vjetri në fshat, ka ndërruar botë-kuptimin.

Pothuajse shumica e anëtarëve të gjinisë së gjyshit kishin ardhur një natë më përpara. Gjyshi kishte vendosur të therte dy desh dhe të bënte edhe një kazan të madh me hallvë, (atë që e bënte vetëm për ditë bajrami zakonisht) por më vonë kishte ndërruar mendim. Kishte menduar se do t'i vinin shumë të afërt këtë vit, dhe kishte vendosur të therte edhe një viç, por atë do ta therte të nesërmen. Meqenëse u grumbulluan shumë vetë, gjyshi vendosi që edhe viçin ta therte një natë më parë. Në këtë kohë që mori vendimin të therte viçin, ishte duke bluar kafe. **E la mullirin e kafesë në anë të vatrës dhe u ngrit.**

— Bluaje kafënë ti, Kaso! — Më tha dhe doli.

Unë mora dhe blova kafënë. Pastaj hapa kasën në mur, të cilën vetëm gabimisht mund ta kishte harruar hapur. Në kasë unë kërkoja kutinë e kafesë, por në sy më ra edhe një letër e shkruar bukur, kjo ma hoqi vëmendjen dhe vura re se kishte vetëm adresën e marrësit, e cila shkruante: «E merr Bajram Hoxha në Livadhas».

Livadhsi nuk ishte ndonjë fshat i njohur por aty dikur ka qenë xhamia, që gjyshi për disa dekada me

radhë ka lutur bajramin dhe ka falur kushedi sa e sa të xhuma dhe torovaja. Desha ta dija se kush ja dërgonte gjyshit këtë letër në emër të vendit ku ka qenë xhamia, por tamam në atë kohë te dera u dha gjyshi. Unë hoqa dorë nga kjo punë për të mos bërë shamatë me të në këtë kohë, por ama më mbeti peng, gozhdë e fortë në zemër adresa, të cilën nuk e kisha parë që nga ajo ditë kur gjyshi kishte ndërprerë korrespondencën me Komitetin Mysliman, i cili ja dërgonte letrat dhe korrespondencat me atë adresë. I lirova qoshen gjyshit dhe hodha kafënë në kuti.

Dita e nesërme erdhi dhe aty u bë një festë e madhe, a thua se po e martonim gjyshin në pleqëri. Kushëriri sollj edhe orkestrën e shtëpisë së kulturës. Të ftuarit erdhën: me kryesi kooperative e me më the e më tha u bënë nja dyqind e ca vetë. Një dasmë e vërtetë. Ama ajo letra sikur më dogji. Për këtë u tregova edhe kushërinjve të tjerë. Nga shkrimi e kisha kuptuar se nuk e kish shkruar njeri nga ne, pastaj pse të mos kishte adresën e saktë ku banon sot gjyshi po atë ku gjyshi ka pasur xhaminë? Kjo ishte e çmos na ishte. Të gjithë na bëri kureshtarë ajo letër. Me çdo kusht donim ta dinim përmbajtjen e saj. Po kush merrte guxim ta kërkonte te gjyshi? Të gjithë po na brente dhe po na gërryente nga brenda mania për të ditë se ç'ishte kjo korrespondencë dhe ç'kishte të bënte Livadhasi në këtë mes tani pasi gjyshi ka hequr dorë nga të gjitha ato që i takojnë xhamisë? Pastaj pse të kishim dyshim, kur ne ishim të sigurtë se gjyshi po festonte ditëlindjen e tij dhe bile edhe të gjyshes sonë (gruas së tij)? Vetëm nuk ishim të bindur pse gjyshi filloi t'i festonte ditëlindjen pa i zënë emrin në gojë. Njëri nga kushë-

rinjtë tanë, ai më i vogli, Xhevahiri, nuk mundi ta mbante më këtë brengë por ja shfaqti gjyshit:

— Gjysh, më duket se në dollapin sekretet ke edhe një letër sekrete, a nuk na e jep ta lexojmë çfarë shkruan dhe kush ta ka shkruar?

— Si? — Ja priti gjyshi i zverdhur dyllë në fytyrë. Buzët ju drodhën përnjëherësh, hapi kasën, e shikoi letrën, e preku, pastaj e mori në dorë dhe, kur u bind se letra ishte brenda, e futi në xhepin e palltos së shajaktë.

— Kush të tha se këtu ka letër? — E pyeti Xhevahirin. Ai rrudhi supet, por xhaxhai, që po rrinte në anën tjetër, me sa duket e kuptoi se letrën do ta kisha parë unë, prandaj e drejtoi vëmendjen tek unë. Unë ula kokën dhe qesha. Në dhomë plasi gazi. Gjyshi mori zjarr.

— Mos ma prekni kasën herë tjetër! — Foli me inat dhe deshi ta digjte menjëherë në zjarrin që bubullonte në vatër. Po Xhevahiri e kapi dhe vrapoi nga dera. Gjyshi e ndoqi. Unë ja mora Xhevahirit letrën nga dora dhe vrapova përjashta, pas meje erdhën të gjithë kushërinjtë e kushërirat dhe mbesat e nipat tanë (barku i shënmërisë). Përmes tyre gjyshi vraponte të më kapte, unë u largova. Te dera e avllisë takuam disa miq të gjyshit që nuk i njihnim. Unë kalova pa u bërë zë, ndërsa gjyshi u përçafua me ta. Pasi u përshëndetën, u priu t'i çonte në dhomën e pritjes. Nga ky rast përfituam dhe u grumbulluam të lexonim letrën. Ajo na habiti me përmbajtjen e saj shumë interesante. Ja se çfarë shkruhej në atë letër:

«I dashtun kumbara im, Bajram Hoxha, ish-hoxha i xhamisë Livadhasit. E mora letrën tande, mbi të gjitha u gëzova kur mora vesh se je mirë me shëndet. Edhe unë mirë jam. Përsa i përket lëvda-



tave që më baje në lidhje me festimin e pashkëve dhe të krishtëlindjeve ke të drejtë. Po, ashtu si thue ti, lum kumbara asht puna. E festoj edhe pashkën edhe Krishtin, por duhet mjaft marifet. Unë këtë marifet e kam sajue me shumë mjeshtëri. Duhet ma shumë dhelpëri se sa trimëri, ore lum kumbara im, se kjo rinia e sotme ta këndon kartën në xhep, edhe po ta kesh të mbyllun në zarf. Dhe në qoftë se të del bosh njani plan, provo tjetrin, derisa ata të zbulojnë të fshehtën tjetër, ti të keshë ba gati tjetrën. Pra unë kështu po i kaloj edhe do ditë të lezetshme. Ja si kam veprue: Për ditën e pashkës festoj ditëlindjen e mamasë, ndërsa për ditën e Krishtit festoj ditëlindjen time. Në qoftë se për pashkët deri dje vinin vetëm pleqtë, tani vjen edhe rinia, se edhe ata më urojnë ditëlindjen e plakës sime. Ata të shkretët axhami, kujtojnë se vijnë për të më urue ditëlindjen, por në fakt më urojnë krishtlindjen dhe, kur më urojnë ditëlindjen e mamasë, më urojnë pashkët. Por ty, or lum kumbara, të paska lanë me gjithëmend Turqia mbrapa. Paskemi pasë hak kur thoshim se ju hoxhallarët ju ka lënë pas Turqia. Po si nuk zutë mend e të dini sadopak dredhi, ore të shkretë? Festoje, more i uruar, bajramin! Ja unë po të mësoj, megjithëse ti asnjëherë nuk ke pranue me marrë mend prej meje. Por, meqë këtë herë ke ra ngushtë, po të them vepro kështu si të them unë, se askush nuk ka me të diktue; po t'i zbuluen këto djallëzi, më pyet mue se të mësoj të tjera. Ja se si duhet të veprosh: Për bajram të madh festo dhe cakto ditëlindjen tande, ndërsa ditën e bajramit të vogël, ose siç i thoni ju, Kurban Bajrami, cakto ditëlindjen e hoxheshës, zaten ajo t'u bëftë kurban ty! Vepro kështu, se nuk

ka me të ra keq! Të përqafoj kumbara yt ish-prifti
i kishës së Pishasit, Dom Lëkunda.»

Kur mbaruam së lexuari letrën, e kuptuam pse
kishte filluar ta festonte ditëlindjen gjyshi.

Atëhere unë e kuptova sepse ndryshonte ditë-
lindja e gjyshit nga dhjetë ditë në vit. Ajo shkonte
një me festën e bajramit të madh. U binda se nuk
kisha gabuar në mbajtjen e shënimeve në kalendar.
Gjyshit ama i thamë se planet e ish-priftit të Lë-
kundës kishin marrë fund.

MREKULLIA E MËSUESIT TË ZOOLOGJISË

— Në short! Në short! Të hidhet shorti! — Bërtiste me sa fuqi kishte drejtori i shkollës i cili ishte rrethuar nga mësuesit. Por zëri i tij nuk dëgjohej mirë, sepse mësuesit ishin ngatërruar ndërmjet tyre se nuk kishin ndjekur radhën e shoqërimit të nxënësve në ekskursion. Drejtori e përsëriti disa herë urdhërin e tij, herë duke e ngritur e herë duke e ulur e përdredhur zërin sikur të ishte ndonjë tenor kori por, duke qenë se zërat e mësuesve nuk akordonin fare me atë të drejtorit, ai rrahu me forcë tryezën duke e goditur disa herë me dorezën e tamponit të bojës dhe bërtiti:

— Pushoni!

Heshtje... Një sekondë heshtje... dy... tri.

Para disa muajsh (kur filloi viti shkollor) mësuesit e shkollës sonë hartuan një listë radhe për shoqërimin e nxënësve në ekskursion. Listën ja dhanë drejtorit. Në fillim sikur u zemërua ca, por, më vonë, kur vuri re se emri i tij nuk ishte shënuar në atë listë-grafik, drejtorit filloi t'i qeshte buza.

— Mirë. — Aprovoi drejtori dhe listë-grafikun e futi në sirtarin e tryezës së tij, atje ku mbante edhe programet e mësimit.

11
*
Që nga ajo ditë kishin kaluar disa muaj. Nxënësit kishin shkuar nja dy herë në ekskursion por për shoqërimin e tyre mësuesit nuk shkuan sipas radhës për arsye të ndryshme që pak interes ka të dihen. Kjo gjë solli grindjen e mëvonshme, kur ekskursioni do të bëhej në kohën e dimrit. Prandaj, atë ditë pas mësimit, ishin grumbulluar në zyrën e drejtorit dhe kishin bërë mbledhjen për të caktuar kush do të shkonte të nesërmen në ekskursion. Asnjëri nuk doli vullnetar, prandaj drejtori urdhëroi:

— Hidhni shortin, radha konsiderohet e prishur dhe lista është e pavlefshme.

— Pse nuk ndiqet lista? — Bërtiti dikush.

— Mos na vononi, lista konsiderohet e pavlefshme. Bëni gati shortin dhe hidhëni! Pse na vononi? — Dha vendim të prerë drejtori.

U përgatitën letrat me vrimë. Shorti u hodh. Me një përtesë dhe shpresë të humbur dukej sikur e merrte letrën e shortit secili mësues. I morën dhe filluan t'i hapnin. . .

— Mos! — Bërtiti me sa fuqi kishte Zenepja, mësuesja e ekonomisë shtëpiake.

— Ç'pate? — Foli drejtori i habitur, që sikur u qetësua për veten e tij.

— Më takoi mua së gjerës që nuk di as të dal nga qyteti. — Foli Zenepja e dëshpëruar duke afruar letrën pranë fytyrës e duke shikuar drejtorin nëpër vrimën si në dylbi.

— E po mirë de, mirë. Edhe ti duhet të shkosh një herë në ekskursion.

— Amani more, se unë nuk di as se ku t'i çoj as t'i sjell.

— Mos u mërzit, se e dinë vetë nxënësit rrugën. — Filloi ta bindte drejtori. Ndofta debati me Zene-

pen do të kishte vazhduar, por në derë u dha Zihniu, mësuesi i zoologjisë.

— Derisa nuk kemi mësuesin e fiskulturës — vazhdonte drejtori — ne kështu do të veprojmë, herë njëri e herë tjetri.

— Për se është fjala? — Pyeti Zihniu, që ende nuk ishte në brendi të vendimeve që ishin marrë disa minuta përpara.

— Lëre, se shpëtove ti. — Ja ktheu drejtori.

— Nga se shpëtova? — Pyeti ai.

— Nga ekskursioni.

— E kush do të shkojë? — Pyeti Zihniu gjithë interes.

— Më takoi mua së shkretës! — Ja ktheu Zenepeja gjithë dëshpërim.

— Mos u mërzit, moj Zenepe. — I dha ca shprese Zihniu.

— Si të mos...

— Shkoj unë në vendin tënd. — Ja ndërpreu fjalën Zihniu duke tundur dy fishekë që mbante në dorë.

— Ashtu? Po të falemi nderit, more Zihni, po ta paça borxh. Po...

Drejtori sikur u çlirua nga një barrë shumë e rëndë dhe foli:

— Bravo, Zihni! Na çlirove nga një barrë shumë e madhe! Kështu si ti duhet të jenë të gjithë të tjerët por... Ah! Nejse edhe ti bën mirë që del nga njëherë.

— Si ore jo? Unë dal gjithmonë, por ju nuk më keni parë.

Të nesërmen që në mëngjez mësuesi i zoologjisë, Zihniu i çoi nxënësit në ekskursion. Sapo dolën nga qyteti morën drejtimin për në pyllin e vogël të mare-

ve. I la nxënësit të çlodheshin për një kohë e pastaj i grumbulloi pranë tij dhe u foli:

— Nxënës, sot do të organizojmë një lojë të bukur që ju nuk e keni luajtur asnjëherë. Ka mundësi që kjo lojë të përfundojë në një mrekulli që do të mbeteni të habitur.

— Urra! — Gumëzhiu pylli nga zërat e gëzuar të nxënësve.

— Dëgjoni, dëgjoni! — Foli mësuesi. Nxënësit heshtën. Mësuesi vijoi:

— Ju do të qëndroni këtu, unë do të fshihem diku në pyll, kur të fishkëllej për herë të parë, ju do të shpërndaheni qysh nga përroi e deri tek ajo lëndina e vogël matanë tij. — Dhe ua bëri me dorë duke u caktuar kufitë e pyllit. Pastaj vazhdoi:

— Pasi të futeni në pyll, do të filloni të më kërkoni derisa të më gjeni. Kërkimin nëpër pyll do ta bëni duke bërtitur: «auau ose uiui» si t'ju vijë më mbarë juve. Në qoftë se unë fishkëllej fort, ju të bërtisni edhe më fort. Një gjë të keni parasysh — përfundoi porosinë Zihniu — në qoftë se dëgjoni ndonjë krismë pushke, të vini me vrap drejt zhurmës!

Mësuesi u fsheh e nxënësit prisnin me ankth fishkëllimën e tij. Ata u shpërndanë në brezin e kufirit që u kishte caktuar mësuesi dhe, sapo deshën të bënin ndonjë pushim të vogël nëpër postat e reja, u dëgjua një «fiufiuuuu» e zgjatur e e stërholluar.

«Auau, uiui». — Filluan të bërtisnin fëmijët nëpër pyll. Lojë e bukur dhe e sajuar mirë kjo për fëmijët.

— Olele ujkuuu! — Bërtiti me të madhe një vajzë dhjetëvjeçare që nuk njihte asnjë nga kafshët veç maces së shtëpisë.

— Olele! — Filloi të ushtonte pylli nga frika e alarmit që dha ajo vajza. Papuf. Krisi një armë. Zëri i saj që ca i mbytur. Nxënësit i kapi frika edhe më keq.

— Fiufiu. — Fëshkëlleu me të madhe mësuesi. Pastaj thirri:



— Ejani more, ejani! Grumbullohuni këtu! Loja ka mbaruar!

Nxënësit filluan të grumbulloheshin. Në sytë e tyre ndjehej një farë trishtimi. Ata ishin trembur nga zhvillimi i ngjarjeve.

— Nxënës! — Foli mësuesi kur u bind se pranë tij ishin grumbulluar të gjithë nxënësit, një pjesë e të cilëve ende vazhdonin të dridheshin.

— Kush më thotë çfarë kafshe është kjo? — Vazhdoi ai duke ngritur nga toka një lepur të vrarë të cilin e kishte kapur për veshësh.

Nxënësit mbetën gojëhapur, të mahnitur nga mrekullia e mësuesit.

Zihniu filloi t'u shpjegonte strukturën anatomike të lepurit.

— Ja! — Vazhdoi ai — kjo është goja e lepurit dhe këta janë dhëmbët e tij dëmprurës...

— Uiiii! si nuk ka frikë mësuesi se mos ja kafshon lepurit gishtin me dhëmbët e mëdhenj! — Foli e frikësuar një vajzë.

— Ky është i vrarë, dhe nuk ka sesi të më hajë. Por unë do ta ha këtë sonte për darkë. — I shpjegoi mësuesi vajzës.

— Çfarë mrekullirash që bëkërka ky mësuesi i zoologjisë! — Folën të habitur nxënësit, kur vunë re se mësuesi pas pak e futi lepurin në një trastë e u tha nxënësve që të ktheheshin në qytet.

INFLUENZUS

Dikur atë e quanin Muharrem Rrapi dhe, për më shkurt e thërrisnin Rremë Rrapi. Por ka kohë që në gjithë uzinën tonë i thonë edhe Rremë Raporta

Në atë kohë Rremë Rrapi (kështu po e quaj tani meqë është fillimi dhe ashtu e kishin pasë thirrë në fillim) kishte filluar të mungonte shpeshherë në punë dhe kjo gjë ndodhte zakonisht vetëm për ditë të shtuna e vazhdonte deri të hënën në drekë, ose nganjëherë mund të vazhdonte deri të martën në mëngjez. Kur kthehej në punë, na sillte edhe modelarin «B» për tri ditë pushim.

Ne interesoheshim shumë për shëndetin e tij prandaj, sapo kthehej nga pushimi, e pyesnim me vëmendje nga çfarë ankohej kur ishte i sëmurë. Të paktën donim të siguroheshim se mos vuante nga ndonjë sëmundje e rrezikshme dhe veç shpjegimeve që na jepte Rrema, i cili na thoshte: «Jo vetëm unë që nuk po e kuptoj se çfarë kam, por as mjekët nuk ma tregojnë, që unë të mos bëhem merak shumë. Se si do të vejë halli më vonë, as unë nuk e di, por mjekët më kanë thënë të shohin». Kaq thosh ai dhe fillonte të punonte. Vinim re se mos jepte ndonjë shfaqje të dhembjeve gjatë ditës në punë por ai meazallah. Punonte edhe më shumë se ne.

Megjithatë neve na ishte mbushur mendja top se Rremë Raporta (kështu quhet tani) me gjithë mend ishte i sëmurë dhe se mjekët kishin të drejtë që i jepnin raport. Kurrë nuk na shkonte mendja që Rrema të ishte razi të humbiste dy ditë punë në javë për... Pikërisht për këtë arsye, kur na sillte raportin, ne grumbulloheshim rreth tij dhe e shikonim me dhimbsuri të madhe. Donim të dinim se çfarë diagnozë e shënonin mjekët në modelarin «B» që i lëshonin atij për ditët që kishte munguar. Një gjë duhet thënë: Rrema na e sillte raportin pasi e bënte pushimin. Në çdo modelar pushimi ai kishte të shënuar diagnozën «INFLUENZUS».

Më vonë e kuptuam që fjala «influenzus» do të thoshte influencë. Për këtë arsye edhe ne filluam të dyshonim se me gjithë mend mjekët do të kishin dituar diçka të rrezikshme të Rrema dhe nuk donim t'ja tregonin, prandaj i shënonin gjithmonë diagnozën «INFLUENZUS».

— Që kur vuan nga kjo sëmundje? — E pyetëm një ditë Rremën.

— Ka kohë. — Shpjegoi shkurt ai.

Kështu e ka zakon. Për çdo pyetje jep një përgjigje të shkurtër dhe nuk të lë më rast ta pyesësh më gjatë.

— Si të ka ardhur në fillim? — E pyeti Albani, shoku i tij që punon në një krah me të, pasi kishte kaluar një copë kohë.

— Me dhimbje koke. — Ja ktheu përsëri shkurt Rrema.

Albani nuk e zgjati më. Jo vetëm ai, por edhe ne të tjerët e kishim të zorshme t'ja kujtonin vazhdimisht këtë gjë.

Një ditë prej ditësh shefja e kuadrit Valdetja

na kritikoi se brigada jonë nuk ishte interesuar asnjëherë të shkonim për vizitë në shtëpinë e shokut Rremë, kur ai ishte i sëmurë. Ne pranuan se kishim gabuar dhe kritikuan shoku-shokun për mungesë korrekte.

E shtuna erdhi. Si zakonisht edhe këtë të shtunë ne Rremën nuk e pritëm të vinte në punë por që në mëngjes e zëvendësuam punën e tij me dikë tjetër.

Kështu bënim gjithnjë kur vinte e shtuna:

Aty rreth drekës njëra nga anëtarët e brigadës sonë, Drita, doli nëpër repart dhe na njoftoi që të nesërmen të mblidheshim e të shkonim për vizitë në shtëpinë e Rremës. Disa nga ne kontribuan edhe me nga një lek (ai që donte të jepte, se njeri nuk na detyroi).

Të dielën kishim lënë takim te pasticheria e qytetit. U grumbulluam të gjithë: Drita, Iliri, Albani, Fëllënza dhe Nifja; kishim zgjedhur një alamet torte dyzetlekshe, të cilën mezi e mbanim në duar. Shpeshherë edhe e ndërronim. Nga shuma e mbledhur na ngelën edhe një tridhjetë lekë; me këta ne blemë dy kile mandarina, dy kile portokalle dhe me pjesën që na teproi morën dhe një dy çokollata.

I kishte hak këto, se ishte i sëmurë, i shkreti Rremë!

— Të shkuara Rremës! — I thamë nënës së Rremës, që na priti e habitur.

— Qyqja, e zeza unë, çfarë ka ba vaki. — Bërtiti ajo me të madhe dhe i ra nga dora paqeta e cigareve të cilën sapo e kishte marrë e deshë të na jepte nga një cigare neve.

— Jemi anëtarët e brigadës së Rremës, moj nëne, kemi ardhur ta shohim që është i sëmurë. Na falni se nuk kemi ardhur edhe herë të tjera, se ai nuk

është sëmure vetëm sot, por ne tani e morëm inisiativën dhe u grumbulluam me ca vështirësi por, ju lutem, na falni! Nejse, të shkuara i qofshin, se çdo gjë do të rregullohet. Mbase nuk sëmuret herë të tjera. — Foli dikush nga ne por që tani nuk e mbaj mend.

— Kush asht i sëmure, more djemtë e nanës? Mos keni ardhë gabim? — Na pyeti ajo me gjysmë zëri. — Cilin Rremë kërkoni? — Shtoi ajo në fund.

— Rremë Rrapin. — Ja priti shpejt Albani duke pasë frikë se ndofta ndonjërit do t'i shpëtonte goja të thoshte se donim Rremë Raportin.

— Këtu banon, unë jam e ama, po më thoni çfarë ka n. . . .

— Na kanë thënë se është i sëmure, bile ai na ka sjellë edhe raport për tri ditë pushim, moj nëne. Ne u bëmë merak dhe erdhëm. Po ku është Rrema?

— Si, ore, qenka i sëmure djali im? Po çfarë e ka gjetë? Medet për nanë zezën, që e kam djallë të vetëm! Pa më tregoni nanës drejt, çfarë i ka ndodhë, ku i ka ndodhë e ku asht tash? Amani mos i fshihni gja nanës!

Ne shikuam njëri-tjetrin në sy dhe mbetëm të ngrirë në vend. Asnjëri nuk ishte i zoti të jepte ndonjë shpjegim.

— Ah! E mora vesh, do të jetë mbytur në lumë, të paktën më thoni a asht gjallë e ku asht, pa që asht mbytur e mora vesh. — Tha ajo dhe nisi të na shikonte të gjithë me vërejtje të madhe, pa na i hequr sytë.

Tani ramë ngushtë shumë, nuk ishim të zotët që edhe njëri-tjetrin ta shikonim të paktën në sy. Ngelëm të stepur në vend. Atëhere ajo na u hodh përsëri:

— Ju që keni ardhë deri këtu, e keni një gja të keqe, more bir, po folni, tregoni drejt nanës!

— Ku është Rrema, moj nëne? — Mori guximin e pyeti Drita.

— Kur nuk dini se ku asht Rrema, pse më keni ardhë në shtëpi? — Na foli me inat nënë Qerimeja, e cila dukej që në pamje se ishte shumë e shqetësuar.

— Gjatë bisedës që ne bënim me nënë Qerimenë, ajo e ngrinte zërin aq shumë, sa që edhe komshitë e morën vesh se në shtëpi të Rremës diç do të kishte ndodhur dhe filluan të vinin.

Ne e kuptuam që Rrema nuk ishte i sëmurë po ecë e dil prej kësaj valleje që e filluam me paratë tona! Nuk thuhet kot nga njëherë: «Jep një para e hyn në valle, por pastaj bëhesh razi të japësh edhe njëmijë e nuk del dot».

— Çfarë i paska ndodhur Rremës, o nanë Qerime? — Thirri njëri nga komshitë.

— As unë e zeza nuk po e marr vesh çfarë të keqe më kanë sjellun këta djem sot, po hajdeni e merruni vesh me ta! — Foli ajo.

Ramë keq. Nuk dinim nga t'ja mbanim. Kërkonim rrugë të dilnim, por s'gjenim.

— A e keni parë sot Rremën? — Na pyeti njëri nga komshitë, që deshi edhe ai të sqaronte ngatërsën.

— Jo. — Ja kthjem ne pak si të turpëruar.

Ah, sa mirë do të ishte sikur edhe unë të mos kisha hyrë brenda me turnin e parë! Ata që ishin në pritje për turnin e dytë e patën më të kollajtë. Sapo dëgjuan këto muhabete, ja mbathën tatëpjetë shkallëve. Nuk thonë kot: «Ai që rrin i fundit, o qan, o qesh». Me sa duket më shumë qesh.



Për fatin e mirë tonin atë ditë Rremës nuk i kishte shkuar shumë mbarë gjuetia. Të tria herët që kishte hedhur grepat, nuk i kishte rënë në ta as edhe një peshk por në fund fare i kishte rënë një breshkë gati nja tre kile. Nga inati Rrema e kishte braktisur atë ditë gjuetinë dhe na gjeti në shtëpi. Në

kohën kur erdhi brenda dhe na gjeti aq shumë të ngatërruar në muhabet, ngeli si dru në këmbë, hodhi grepat përtokë, uli kokën dhe s'qe i zoti as të na përshëndeste.

Ne i folëm:

— E, o Rremë?

— Hiç — foli i turpëruar ai.

— Nuk kape gjë sot? Me sa duket nuk të paska ecur mbarë.

— Ehë! Sot ju shkoi juve mbarë. Më kot prita të binte ndonjë peshk në grepin tim se... Rashë vetë në rrjetën tuaj. Më falni, shokë! Nuk do ta përsëris më!

Ndërsa Rrema thyente kallamat, ne qeshnim për «influencën» që çuam në shtëpinë e tij për t'i hequr vesin që të mos pranonte të bëhej herë tjetër «simulant».

SEZONI I PUSHIMEVE DIMËRORE

Pas dy orësh që kisha filluar punën, shefi i kuadrut më thirri në zyrë dhe më tha:

«Ti, Zaho, akoma nuk e ke bërë punën prodhuese. Apo e kam gabim?»

— Jo. — Pohova unë.

— Mirë pra. Hajde të vemë te përgjegjësi i punishtes.

Përgjegjësi i punishtes as më pyeti as e zgjati fare muhabetin por më urdhëroi që punën prodhuese ta kryeja në kooperativën bujqësore «Udha e Mbarë».

— E po të qoftë udha e mbarë pra! — Më tha ai duke më shtrënguar dorën. Pastaj më porositi: — Atje nuk shkojnë mirë punët me rendimentin. Në parcelat e rendimenteve të larta kanë marrë prodhimet të bollshme, por janë keq në aktivitetet e tjera. Prandaj ti duhet të punosh me të gjitha forcat dhe aftësitë e tua teknike-shkencore në mënyrë që edhe në kooperativën ku shkon ti, të ndjehet ndihma që i jep ndërmarra jonë fshatit. Të duket se ka shkuar një njeri me aftësi...

— Unë...



— Këtë porosi e kam nga kryeagronomi i rrethit, ai e kërkoi me...

— Unë jam specialist vetëm për sallame, shoku shef dhe...

Ai ma preu fjalën shkurt:

— Edhe kjo i vlen kooperativës bujqësore. Atje nuk kanë punishte sallamesh, por ama kanë të atilla aktivitete që i përshtaten profilit të punës suaj.

Nejse.

Të nesërmen u gjenda në fshat. Sapo zbrita nga maqina takova një kooperativist që mbante dy kuaj për kapistalli. Ai më priste mua.

— Mirë se na erdhe, shoku shef! — Më tha ai dhe m'u afrua e më dha dorën.

(Në fillim kujtova se me mua po ndodhte ndonjë keqkuptim ashtu siç ka qenë bërë zakon të ndodhte shpeshherë me ata që kanë shkuar në fshat për punë prodhuese. Por më vonë çdo gjë u sqarua dhe u vërtetua se edhe unë quhesha me të drejtë shef).

— Mirë se ju gjeta! — Ja ktheva unë dhe i shtrëngova dorën.

— E mora me mend se sot duhet të vije pa tjetër, prandaj dola të të prisja. Ja edhe kalin tek e ke. Po ai mezexhiu a nuk erdhi?

Unë mbeta pak i habitur nga kjo pyetje.

— Si?

— Ai pra, që na premtuan se do të vinte për punë...

Dhe sakaq nxori nga xhepi një letër të hapur, mjaft të zhubravitur e ma dha mua.

Në fillim mendova se ishte fjala për shefin e seksionit të bujqësisë dhe ndofta ai po më merrte mua për shef. Për këtë nuk desha ta lexoja, (s'është e rregullt të lexohet letra që nuk të adresohet personalisht), por kooperativisti më sqaroi:

— Asht për ju; prandaj kam dalë, t'ju pres.

Kur lexova letrën që kishte një përmbajtje të çuditshme, e kuptova se me gjithë mend fjala ishte për mua dhe më prisnin me padurim.

Ja çfarë shkruhej:

«I dashur shef!

Mora letrën tuaj dhe u shqetësova ca. Ti më shkruaje ose më mirë me thanë më urdhëroje që unë të baja një mbledhje të gjerë për të diskutue problemin e rritjes së rendimentit për ditë-pune. Këtë problem unë e kam pasë parasysh me kohë, prandaj unë kam ba ma shumë se dhjetë mbledhje me protokoll duke lanë mënjanë dhjetëra të tjera që i kam ba pa protokoll. Pra ty të ka shkue mundimi kot.»

Nejse. Letra ishte e shaptilografuar dhe e nuhata se ajo ishte një udhëzim uniform për të gjitha kooperative.

Pa unë, që ta marrësh vesh ti, shoku shef, jam i rreptë në çeshtjen e rritjes së rendimenteve për ditë-pune. Për këtë që të them kam shembuj bindës.

Nejse, u zgjata ca por e vlen. Tani unë due të të ve në dijeni për një inisiativë të mrekullueshme që e ka vendosun kryesia dhe po e zbatojmë me përpikmëni e po na jep rezultate të mira.

Ja si asht puna:

Ka qenë ba zakon që dasmat të baheshin në vjeshtë. Zakon jo i përshtatshëm ky. Prandaj kemi vendosun t'i bajmë në dimën. Për këtë kemi ba një grafik dhe e kemi aprovue në kryesi. Grafikun e bajmë me qëllim që të mos bien dy dasma për një ditë. Pra, ne kryesia dimë se ku t'i drejtojmë bateritë. Këtë të diel martohet Ramazan Qelepiri, i cili asht edhe anëtar i kryesisë. E kemi ndihmue të bajë dasmë të mirë por, të lutem, ta ndihmoni edhe ju! Për këtë, të

11*

lutemi, mos na ban të na dështojë plani, se dimë çfarë luge të marim me vete. Të lutemi, që edhe ju mos na lini vetëm te damixhani i rakisë e të tava e mi-shit. Asgja nuk na mungon, çfarë varet prej nesh, ja kemi dhanë të gjitha, por mos na ba të na dështojë ai gëzim që duem të bajmë për një anëtar të kryesisë.

Nga ju nuk duem gja tjetër por vetëm të na gje-ni një njeri që din të pregatisë meze të mira, nga ato që nuk të veleritin. Duem të bajmë për Ramazanin një dasmë allaqytetare që të jetë model në fshatin tonë. Prandaj, të lutem, na ndihmo me një mezexhi. Të presim patjetër me gjithë mezexhiun. Kur të vish këtu, do të flasim edhe për disa probleme të rendi-mentit. Për rendimentin e dasmave dhe të. . .

Të lutemi edhe një herë na ndihmo se, sado që të punojmë me bateri të përqëndrueme, prapë nuk ja dalim dot, prandaj të presim patjetër e të na vish me gjithë mezexhiun se, për nder, nuk jua dalim dot asaj rakije dhe atyre mezeve që kemi planifikue të bajmë.

Mos u prek pse të fola kështu, por desha të të mbushja mendjen, megjithëse ti asnjëherë nuk më ke lanë në baltë për të tilla raste.

Nejse. Unë shfaqta vetëm dyshimet e mia, se sa për mendimin e kryesisë jam i sigurtë se ti do të vish dhe të presim te Ura e Thatë me gjithë dy kuaj.

Të fala me mall

kryetari i kooperativës «Udha e mbarë»

KK

Firma ishte krejt e lexueshme por vula e zhytun me bojë.

Ndofta anën tjetër nuk do ta kisha lexuar **por,**

meqë paska lidhje me emërimin tim, u dashka lexuar. Ana tjetër ishte shkruar me stilograf, shkrimi ishte i trashë dhe u ngjiste brazdave të arave. Dukej se ishte shkrim agronomi.

Letra fillonte kështu:

«Dëgjo këtu, ore shoku kryetar!

Shefi sot nuk ndodhet këtu. Sapo të kthehet, do ta njoh me përmbajtjen e letrës. Por për mendimin tim s'besoj të vijë.

Përsa i përket personit që kërkoni me urgjencë, u interesova unë. U nis një specialist nga punishtja e sallameve. Ai është i zoti sa, edhe të gjitha bagëtitë sikur t'i therni për një natë mund t'jua servirë për meze si t'i keni qejf ju e si ta kërkojë nevoja e oreksit në dasmë. Në qoftë se nuk vjen shefi, mos i vërë faj, pasi kemi një ftesë si seksion në kooperativën «Malësia». Mund të vemë të gjithë atje se malësorët janë pak më kavalierë në të tilla raste. Këtë e vërteton edhe fakti që ju kërkoni një mezexhi për të përgatitur edhe mezet me pjata. Ndërsa malësorët me siguri do t'i nxjerrin me sahanin e madh.

Nesër nxirr një person në xhade me një kalë se të vjen mezexhiu (ndofta bashkë me shefin).

Ramazani të trashëgohet e shëndet të ketë për ato shpenzime që i paskeni vënë ju si kryesi!

*Të fala në këmbë të shefit
kryeagronomi GG»*

E po edhe kjo nuk është parë. Të të nisin urgjent për punë prodhuese e pa mbërritë akoma të të dërgojnë emërimin shef...

Dhe u zhyta në mendime: «Si mund t'ja dilja gjithë atij aksioni pa asnjë mjet pune me vete? Kur

11°
çeshtja qenka kaq serioze, pse nuk më paskan dhënë me vete maqinën e grirjes së mishit, të prerjes së bërçollave, të biftekëve, të përgatitjes së qofteve? A do të pëlqehet sa duhet puna ime? A duhet të kem me gjithë mend një rendiment të lartë në punën time?>

Mendimin tim e ndërpreu kooperativisti:

— Po ti mos u mërzi, more burrë. Ç'hall ke që mendohesh?

— !?

— Ne me pushime jemi. Edhe ty të ndihmojmë, edhe ne mësojmë. Megjithëse jemi me pushime, punojmë dhe nuk të lëmë të lodhesh shumë.

— Mirë që më paskan emëruar këtu te ju, që jeni pak më të matur se...

— Ke patur fat se po të të kishin dërguar në malësi, do të të shkonte djersa çurg më tepër se Zalos sonë. — Ma ktheu kooperativisti. — Po ti hajde e mos u mërzi se ne me pushime jemi e të ndihmojmë, nuk të lëmë vetëm...

I zemëruar për këtë emërim të papritur që më kishin bërë duke ma dërguar emërimin si guzhinjer para se të arrija desha të kthehesha e të vrapoja në seksjonin e bujqësisë për t'u sqaruar, por tamëm në atë kohë që u bëra gati të largohem, lart mbi xhandë e makinës dikush më foli:

— Eeej, Zaho, eja shpejt more se kemi filluar të themer mishërat e nuk ka kush të na përgatisë mezerat, Ec ca shpejt, të lutem, se ka ardhur edhe shefi i bujqësisë e po presim të shtrojmë rakinë por na pengon mezeja e i duam allaqytetarëshe, e jo shaka...

Ishte kryetari i kooperativës ai që kishte rënë në hall se nuk kishte përgatitur meze të mira për shefin.

TJEGULLA ME BIRË

Në lagjen tonë banon një usta i moshuar. E quajnë Simon, po të gjithë ne e thërrasim xhaxha Simonin. Ndonjë gjë shumë të çuditshme për xhaxha Simonin nuk kemi për t'ju thënë, por vetëm duhet vënë në dukje se për zënnen e pikave të çatisë është një usta i përmendur në lagje.

Së paku kështu i ka dalë nami.

Dikush thotë: «Simon Sinapi ka lindur me çekan e me mistri në dorë». Por, sa është e vërtetë kjo thënje, mund ta dijë vetëm e ëma që e ka lindur, sepse njeri tjetër nuk ka asistuar në lindjen e tij, pasi siç dihet në atë kohë në qytetin tonë nuk kishte maternitet.

Kur vjen vjeshtë dhe bien shira, dihet që shpeshherë në çatitë tona fillojnë edhe pikat. Ato zbresin nëpër tavane dhe na krijojnë ndonjë valle uji nëpër dhomat, atëhere ne e kuptojmë se po na pikon çatia. Të tilla ndodhi janë të shpeshta nëpër shtëpiat me tjegulla. Njerëzit që banojnë në këto shtëpia thonë:

«Epo, sa të presim të vijmë ustallarët e komunalës, më mirë po thërrasim xhaxha Simonin që e kemi këtu në lagje. Ai na vjen më shpejt se ustallarët e komunalës».

Kështu ndodhi që edhe Mehmet Mastari, kur pa se në tavanin e njëres nga dhomat e shtëpisë filluan t'i dukeshin ca valle të lagura që me shirat e para të vjeshtës, vendosi të thërriste Simonin për të zënë pikën.

Merreni me mend se çfarë do të ndodhte kur të vinte dimri e të shtohej shiu. Po sikur të binte breshër?

— Heu bre! këtu nuk ka pasë pikue asnjëherë!
— Foli i habitur xhaxha Mehmeti dhe ju drejtua të birin, Bedriut: — Si asht e mundun more?..

— Mos u shqetëso baba — ja ktheu Bedriu — nesër shkoj unë në komunale dhe njoftoj. Ata do të na dërgojnë usta shumë shpejt.

— Ç'komunale more? Ku të dërgon komunalja njeri për një pikë?!

— Të dërgon e bile shumë shpejt. — Ja ktheu i biri për ta qetësuar.

— Dëgjo këtu, more bir — ja ktheu xhaxhai me të mirë — komunalja për kësi punësh nuk besoj se dërgon usta. Edhe në e dërgon, do ta vonojë nja gjashtë muej. Mue nuk më duhet ustai në pranverë, se atëhere... Por shko shpejt e thuej Simon Sinapit të vijë! Shiko mos ka dalë te bufeja. Unë atje isha, por nuk e takova, dikush duhet ta ketë marrë në shtëpi se atje te bufeja kishte edhe të tjerë që prisnin ta merrnin. Ti ma mirë shko drejt e në shtëpi. Thuaja, se vjen menjëherë.

— Po sikur... .

— Vetëm ai e di se çfarë defekti ka çatia jonë, more biri im. Ata të komunales nuk dinë nga bie çatia jonë e jo të dinë se ku pikon.

— Më mirë thuaja vetë pra, more baba, se mua më... .

— Ai e ka pasë zakon, sa herë binte shi, dilte vetë nëpër lagje. Më ka rastisun të vinte vetë e të thoshte: «Të ka pikuar te salloni?» E pra bash njaty më kishte pikue edhe mue. S'ke ç'i thue atij ustai. Hajde me babën shko e ma gjej e mos. . .

— Mos ofendohen ato të komunales, more babë, pa unë. . .

— Pa lene mënjanë atë fjalën komunale njëherë! Mos e zgjat shumë se shkon ndokush tjetër përpara e, kur të na vijë radha neve.

— Po a do të vijë?

— Mos ja ki hallin për të ardhur. Ama duhet t'i japësh pesëlekshin në dorë. Atë e don dhe e ka hak. Si t'i japësh pesëlekshin, prite se për një orë pika të është hequn prej shtëpie dhe tavani të ka shpëtue nga rreziku.

— Baba!

— Çfarë ke?

— Mua si nëpunës i komunales nuk më lejohet një gjë e tillë.

— M'u hiq andej me gjithë komunale! Ajo akoma nuk ka mbulue pusët e rrugëve, ti më thue për çatitë.

— Po ne kemi. . .

— Unë të them se ju të komunales nuk jeni në rregull në tokë, ti më thue se keni mundësi të bani riparime në çati, llafe në hava! Do të shkosh apo të shkoj vetë? — E mbylli bisedën xhaxha Mehmeti.

— Mirë, baba, nuk po ta prish këtë herë.

Që atë mbrëmje Bedriu vrapoi drejt e në shtëpi të Simon Sinapit. Se mos e kishte shumë larg. Lumëmadhi në lagjen e tij ndodhej.

Xhaxha Simonin e kishte pasë zënë një grip i lehtë dhe sa ishte shtrirë. Ama s'i rrihej në krevat,

që kur zuri shiu. Ai sikur e dinte se të tjerëve kishin filluar t'u pikonin çatitë dhe duhej filluar nga pikat.

Bedriut i erdhi zor t'ja zinte në gojë këtë muhabet por e pyeti si ishte e çfarë kishte.

Ndërsa xhaxha Simonin nuk e mbante krevati. Prandaj e pyeti:

— Ju ka pikue shtëpia prapë, ë?

— Jo, jo, jo. — Ja ktheu Bedriu. — Të falemi nderit. Qysh kur ke vënë dorë ti, ne jemi rehat.

Xhaxha Simoni u kollit një herë dhe u kthye nga krahu tjetër duke vrarë mendjen: «Si asht e mundun? Unë e mbaj mend mirë se aty kam vu një tjegull me goxha birë? Të këtë qenë fallco ajo birë? Jo, s'ka mundësi. Atë e kam pasë vu te dhoma e madhe, aty ku. . .

— Nuk ju ka pikue te dhoma e madhe? — Pyeti pas pak plaku.

— Jo, jo, jo. — Ja ktheu Bedriu dhe një habi e madhe e pllakosi: «Si është e mundur që edhe ky e din se ku na pikon shtëpia neve? Ne shpesh dërgojmë ustallarë dhe ata mezi i gjejnë ato të uruara pika! Kurse ky i din pa ardhur në vend. Paskan të drejtë njerëzit që thonë se xhaxha Simoni. . .»

— Aty duhet pasun kujdes — ja ndërpreu mendimet xhaxha Simoni — se tjegullat kanë qenë të vjetra dhe ka mundësi. . .

— E po fundja çfarë faji ke ti, ore xhaxha Simon, pse tjegullat e shtëpisë sonë janë të kohës së babaqemos? — Foli një banor tjetër për të cilin Bedriu kujtoi se do të kishte ardhur rastësisht por më vonë e mori vesh se edhe ai për punën e pikave ishte munduar.

— Të babaqemos the? — E pyeti xhaxha Simoni.

— Po. — Ja përforcoi Bedriu.

— Thuej ma mirë se janë qysh të babës së baqemos. — Ja ktheu xhaxha Simoni. — Jam unë që i mbaj në kambë çatitë e kësaj mëhalle se, po të kishin ndenjur në fatin e komunales, e huha çfarë do të ishte ba. Edhe kur i riparoi duket sikur të gjitha tjegullat e saj janë me brima. Pikojnë të gjitha çatitë që riparoi komunalja.



— Ka rrezik të pikojnë edhe kur asht diell. —
Shtoi ai banori.

— Ashtu asht. — Ja ktheu xhaxha Simoni duke
i dhënë rëndësi vetes.

Bedriu deshi të largohej. I dha dorën xhaxha Si-
monit dhe u nis të dilte. Te dera u dha Kristofori, i
biri i xhaxha Simonit. Ai punon në komunale dhe
njihet mirë me Bedriun.

— Bedri! Mos kishe ndonjë hall? — E pyeti Kri-
stofori kur po i jepte dorën e po e përcillte.

— Të të them të drejtën, more Kristofor — ja
ktheu Bedriu — erdha t'i them xhaxha Simonit se na
ka pikuar ca tavani. Por xhaxha Simoni qenka usta e
shkuar ustait. — Vazhdonte Bedriu. — Si ore edhe
aj e dinte se ka pikuar te dhoma e madhe e shtëpisë
sime? Për nder, më habiti! Nuk desha ta shqetësoja
të shkretin, se ishte i sëmurë e i thashë se nuk kisha
asnjë hall. Paska pasë të drejtë baba që ngulte këm-
bë se vetëm xhaxha Simoni e din se ku i pikon shtë-
pia gjithsekujt. Tani qenka i sëmurë dhe nuk kam se
çfarë t'i them.

— Për hatrin tënd po vij unë e t'i heq pikat,
Bedri. — Ja ktheu Kristofori dhe e tërhoqi për krahu
e vijoi rrugën bashkë me të.

— Din ti të ndërrosh tjegulla e të riparosh çati?
— E pyeti i habitur Bedriu.

— Nuk e di ti se unë kam kategorinë e pestë si
murator?

— Po, more, e di po...

— Të ndërroj tjegulla kam mësuar qysh kur
isha në shkollën e rezervave të ndërtimit. — Ja
ktheu Kristofori.

Bedriut ju hoqën mendimet se ky nuk dinte të
ndërronte tjegulla.

— Të falemi nderit! — Përshëndeti Bedriu dhe të dy vijuan rrugën.

* * *

Kristofori u ngjit menjëherë në çati dhe kontrolloi atë vendin ku pikonte. Konstatoi se njëra nga tjegullat që ndodhej mbi vallen e ujshme që ishte krijuar në tavan ishte e brimosur. Ai e hoqi tjegullën nga vendi dhe e hodhi poshtë.

Tjegulla ra në kalldrëm dhe për çudi nuk u thye.

Kristofori bëri spostimin e tjegullave të tjera e, pasi e mbuloi atë vendin që mbeti bosh, zbriti poshtë.

— Nuk ka për të pikuar më. — I tha Bedriut.
— Kishte qenë kjo tjegulla me brimë që e kishte prishur punën. Kjo do ta ketë turpëruar edhe dorën e babait tim.

— Me birë?

— Po. — Ja ktheu Kristofori dhe kureshtja e bëri ta merrte në dorë e ta shikonte. Tjegulla në pamje dukej e re. Në mes të saj dukej një brimë. Ishte hequr një copë. Anës vendit ku ishte hequr copa dukej një goditje e vogël.

— Si është e mundur të jetë hapur kjo brimë në mes të tjegullës? — E pyeti i habitur Bedriu Kristoforin.

— Ndofta ka gjuajtur ndonjë fëmijë me llastik.
— Ja ktheu Kristofori dhe e hodhi tjegullën mënjane, atje ku hidhen mbeturinat.

— Ku ishte? — E pyeti xhaxha Simoni Kristoforin sapo shkeli në derë e ende nuk ishte ulur.

— Shkova deri te shtëpia e Bedriut, te xhaxha Mehmeti. — Ja ktheu Kristofori.

— Pse?

— I pikonte shtëpia.

— Çfarë? — Pyeti i habitur xhaxha Simoni.

— I pikonte një pikë nga çatia. — Ja përsëriti edhe një herë fjalën i biri dhe, pasi hoqi mushamanë, u ul pranë vendit ku ai ishte shtrirë.

— Te dhoma e madhe?

— Po. — Ja ktheu Kristofori.

— Po ti çfarë bane?

— Gjeta një tjegull të brimosur dhe e hoqa. — Ja ktheu i biri pa i dhënë rëndësi fare asaj historisë se si ishte tjegulla.

— Ku e çove tjegullën? — E pyeti xhaxha Simoni dhe një farë shqetësimi ndjeu në vetëvete e filloi të mallëkonte atë drejt gripi që e zuri tamam atë ditë që filloi të binte shi.

— E hodha poshtë, se kishte turpëruar duart e tua.

KUR FILLON TË SHKRIJË BORA

Kiamet i shpejtë ky brigadieri ynë. Vetëtimë. Gjatë dimrit, kur fshatin e kishte mbuluar dëbora, ai kapej kollaj, se i shkonim pas gjurmëve, por e keqja është tani që ajo filloi të shkrijë.

Atë ditë më duhej ta takoja pa tjetër. Bora, që pati mbuluar fshatin dhe malet rreth tij, filloi të shkrinte, kjo solli të mirat që na liroi tokat por solli edhe të këqiat e saj: Ujët e borës na mbuloi arat, na prishi jazin e mullirit, na mbushi stallat, na... Eeeh! më kot nuk thuhet se pas çdo të mire vjen edhe ndonjë e keqe, po nuk dite t'i dalësh përpara.

Që në mëngjez vura re se ishte prishur jazi i mullirit. U përpoqa ta rregulloja vetë, por ishte e kotë. Vrapova të kërkoja ndihma por, kujtdo që t'i ankohesha, nuk mund të më ndihmonte pa urdhërin e brigadierit. Hapa sytë andej nga arat ku ishin rreshtuar me qindra kooperativistë. «Atje duhet të jetë», mendova me vete dhe vrapova.

Kur u shkova afër, vura re se kooperativistët bënë kanalet e kullimit. «Këtu duhet të jetë», mendova.

— Ku është brigadieri? — I pyeta pak me turp

se thashë do të më thonë: «A mos je qorr që nuk e sheh tek hap kanal?» — Por isha gabuar.

— Pse e don? — Ma kthyen ata pa e ngritur kokën nga kanali.

— Është thyer jazi i mullirit, më duhen punëtorë ta rindërtojmë. . .

— Na ka thënë se do të jetë te stallat sot. Këtej nuk ka ardhur.

Vrapova te stallat që janë nja tre kilometra larg arave ku punonin kooperativistët për hapjen e kanaleve të kullimit.

Të pesë stallieret me kova në duar e me pantallona të përveshura deri mbj gju mundoheshin të hiqnin ujët që kishte vërshuar nga çatia. Uji i ftohtë i borës së shkrirë ishte përzier me urinën dhe plehun e lopëve e ua kishte skuqur këmbët flakë stalliereve, por ata nuk tërhiqeshin nga vështirësitë.

«Me siguri — thashë — edhe brigadieri këtu duhet të jetë. Ah! Ç'brigadier i mirë! Shkon gjithmonë atje ku është fronti më i vështirë», mendova. Shikova për një çast duke e kërkuar në mes tyre, por jo. Isha gabuar.

— A e keni parë brigadierin? — Bërtita me të madhe duke u munduar që zëri im ta mposhte zhurmën e kovave e stallierët të më dëgjonin mirë.

— E pse e do? — Më pyeti njëra prej tyre.

— Më është prishur jazi i mullirit, do të na mbetet kooperativa pa miell, pa bukë, pa. . .

— Na ka thënë se sot do të shkonte në kotecet e pulave. Atje duhet të jetë. Këtej nuk ka ardhur as sot as dje. — Ma kthyen pa e ndërprerë punën; as drejt në sy nuk më shikoi ndonjëra prej tyre.

Vrapova te kotecet që janë në drejtimin tjetër të fshatit, nja pesë kilometra larg stallave. Duke

vrapuar për atje, mallëkoja ata të urbanistikës që nuk kanë dhënë me kohë planet rregulluese të fshatit, por e lënë kooperativën t'i vendosë objektet një te krushka e një te mushka.

Të tre stallieret e pularisë vajtonin me të madhe njëqind e pesëdhjetë pulat që u kishte copëtuar dhëlpëra atë natë. Disa prej pulave të copëtua ishin në gjendje të mirë. Stallieret i ripnin, i futnin nëpër kosha, i ngarkonin në kuaj dhe i transportonin për t'ja dorëzuar klubit. «Ah, të shkretat pula», mendova.

— A e keni parë brigadierin? — Fola mengadalë për të mos u prishur melodinë e vajtimit stalliereve.

Ganimeti, përgjegjësja e pularisë, ndaloi vajtimin, ngriti kryet, fshiu lotët dhe ma ktheu:

— Sot nuk ka ardhur këtej. Ka tri-katër ditë që nuk e kemi parë. Shiko se mos është andej nga bëhen kanalet e arave! Kështu kishte thënë sot kur ishte nisur nga shtëpia. Edhe ne e duam se...

«Aaah, thashë me vete, sa i shpejtë ky brigadieri ynë. Ç'deshe që u shkrive, moj dëborë, se na humbe gjurmët e brigadierit.» M'u duk se të gjitha shpresat për ta gjetur ishin të kota, por isha gabuar.

— Kë kërkon, more Belul Ziu? — Më foli Tahiri, njëri nga kafsharët që atë ditë merrej me transportin e pulave të therura nga dhëlpëra.

— Brigadier Selimin. — Fola unë pak i drojtur.

— Hëhëhëhëhë. — Qeshi Tarja duke zgjatur buzën vesh më vesh e duke zbardhur dhëmbët si për inatin tim. — E pse e kërkon? — Shtoi ai pasi ishte ngopur së qeshuri.

— Më është shkatërruar jazi i mullirit. Kooperativa do të...

— Shko se e ke te klubi. — Ma ktheu duke qën-

druar serioz e duke folur me avash që të mos e
dëgjonin stallieret.

— Je i sigurtë?

— E ndjeu erën e pulave më lehtë se dhelpëra.

— Foli përsëri ai. — Shko se mund të të takojë edhe
ty ndonjë kofshë!



Vrapova te klubi që është në drejtimin e kundërt të stallave të pulave. Ah, urbanistikë, çfarë na ke bërë? Na le ta shpërndajmë fshatin.

Dera e klubit ishte e mbyllur. Tashmë i humba të gjitha shpresat. Edhe ajo pak kurajo, që më dha Tarja, m'u shua. Bëra të gjitha përpjekjet për të hapur derën, por ishte e kotë. Fillova të trokisja me të fortë, por më ndaloi kamerieri.

— Çfarë kërkon që i bie derës, more?..

— Brigadier Selimin. — Fola unë me të madhe.

Heshtje. Një sekondë, dy, tri..

— Shko se është nga arat. — Ma ktheu kamerieri.

— Tek arat isha, po ai nuk ishte. — Ja ktheva unë.

Heshtje. Një sekondë, dy, tri..

— Mos është te stallat. — Përforcoi kamerieri.

— As te stallat, as te lopët, as te pulat nuk është.

— Ja shkurtova.

Heshtje. Një sekondë, dy, tri..

— Atëhere duhet të jetë në zyrë. — Ma ktheu për të fundit herë.

— A e di mirë?

Heshtje. Një sekondë, dy, tri..

— Në mos është, prite, se duhet të vijë.

— Nga e di ti? — Pyeta unë i habitur për të gjitha këto përgjigje kaq interesante.

Heshtje. Një, dy, tri..

— Ashtu më tha kur piu kafe në mëngjes.

Vrapova te zyra e brigadierit, e vetmja zyrë e vendosur, siç duket, me plan rregullues, se vetëm kjo ndodhet afër klubit nja treqind metra.

E kotë.

Zyra ishte mbyllur. Fillova të mallëkoja: «Ah, moj borë e bardhë, sa të zeza na solle! Jazin na e

prishe! Arat na i mbulove me ujë! Stallat na i shkruhe! Pulat i bëre kurban te dhëlpëra! Brigadierin na e... ë! Ah! Jo jo! Mos qoftë e thënë të jetë shkrirë edhe ai si ti! Po ku të jetë? Më mirë të mos e gjej se sa të jetë shkrirë bashkë me borën! Po po. Më mirë...»

— E pse lllomotit me vete, ore Belul? — Më foli Kasemi — përgjegjësi i stallave që kishte zënë një stol e priste edhe ai si unë. Donte të takonte brigadierin, por ishte në pritje prej kohësh. E dëshmonin grumbulli i hirit të duhanit dhe bishtat e cigareve që ishin bërë sa një mullar bari para këmbëve të tij.

— Dua pak brigadier Selimin por...

— Edhe unë atë dua, se stallat janë në pikën e hallit por ja që akoma nuk ka mbaruar së peshuari pulat.

— Pulat? Ç'pula, a derëzi? Ku ishte ai te pulat?

— E pashë unë. Është brenda në klub duke ja dorëzuar me peshë kuzhinës.

— Po unë...

— Mos e zgjat — ma ndërpreu Myftari — roja e natës në kotece — edhe mua ashtu më thanë. Prandaj po e pres se më duhet pa tjetër për të firmosur...

Bisedën tonë prej gati dy orësh e ndërpreu ardhja e brigadierit, i cili ecte kokulur duke u tundur sa nga njëra anë në tjetrën. Kamerieri dhe kuzhinieri e mbanin për krahësh dhe e tërhiqnin për ta sjellë në zyrë.

Kur erdhi pranë nesh, qëndroi. Ngriti kryet lart, mori pamje serioze dhe ju shkreh Kasemit:

— Pse nuk ke shkuar te stallat?

— Erdha të të them se ato po shkrehen, pikojnë. Duhet me...

— Nuk rregullohen ato tani në pranverë. Tani nuk mërdhahin lopët. — Ja preu fjalën në mes. Pastaj u kthye nga Myftari dhe e pyeti si me buzqeshje:

— Po ti, roja e pulave, çfarë don?

— Erdha të më firmosësh procesverbalin për shkarkimin e pulave. — Foli i gjori Myftar i frikësuar duke dredhur zërin nga merakë se ndofta brigadieri mund ta quante fajtor për mosnuhatjen e dhelprës që ishte futur nga muret e rrëzuara prej kohësh.

— Sa pula ka copëtuar dhelpera, more?

— Pesëdhjetë i ka ngrënë fare. Njëqind i ka copëtuar dhe i ka lënë gati për një natë tjetër por sonte le ta provojë të vijë se... — Filloi të justifikohet Myftari duke treguar pushkën që mbante në krah.

— Ku i çuat ato të dëmtuarat? — Pyeti brigadieri duke zgurdulluar sytë sa nga kamerieri sa te kuzhinieri.

Tani u bindëm ne se brigadieri nuk kishte qenë duke i peshuar pulat për t'ja dorëzuar kuzhinës me inventar, por...

— Ja kemi dorëzuar klubit. — Pohoi i gjori Myftar duke folur me gjysmë zëri. Ja kishte frikën brigadierit, se ai edhe mund të mos e linte më roje.

— Sa i dorëzuar klubit? — Pyeti edhe një herë brigadier Selimi për t'u bindur se nuk u zinte besë veshëve të tij.

— Njëqind copë rrumbullak. — Pohoi Myftari.

Kur dëgjoi për të dytën herë fjalën njëqind, brigadier Selimi u vrejt në fytyrë dhe ju shkreh kuzhinierit:

— More... po dhelpera që ka një mickël bark paska ngrënë pesëdhjetë kokë pula të gjalla pa i

pjekur fare! Kurse ti na dhe tre burrave me goxha bark vetëm një pulë të pjekur shumë të vogël. Pa vrapo. . shpejt edhe nja dy të tjera në hell!

Kuzhinieri nuk e zgjati. Vrapoi drejt ndërtesës së klubit për të zbatuar urdhërin e brigadierit, ndër-
sa ai u kthye nga unë. Ishte i zemëruar me kuzhi-
nieren dhe mezi mundi ta përqëndronte veten.

— Po ti, more Belul Rrota, pse e ke lënë vetëm mullirin, a e din se duan të bluajnë?

— Më është thyer jazi, më duhen punëtorë, koo-
perativa mbetet pa bukë. . .

— M'i thuaj një nga një, mos m'i ngatërro të gjitha njëherësh, se. . .

— Mullirit nuk i vjen ujë, se është shembur jazi, kanali.

— Nuk bluan mulliri fare? — Më pyeti i habitur duke sjellë dorën në formë rrethi para vetes.

— Unë të them nuk ka ujë, kurse ti më pyet nëse bluan apo nuk bluan. . .

— Nuk silllet fare? — Më pyeti për të dytën herë duke e zmadhuar rrethin që bënte me dorë para barkut.

— Jo.

— Hmmm. — Mumuriti. — Sa pa vend i bë-
ni ju ankesat dhe kërkesat. Unë e shoh me sytë e mi
që silllet e gjithë kooperativa rreth meje. Kurse ti
më thua nuk silllet mulliri, që është për atë punë. . .
Shko, Belul, shko dhe ki kujdes, për herë të tjera
mos u mundo të ma hedhësh mua.

Kaq tha ai dhe u nis të largohej drejt klubit.

JU LUTEM, MOS QESHNI!..

Kur hyra në zyrën e drejtorit, atë e gjeta në këmbë. Po pinte një cigare duke thithur me shumë oreks tymin e saj të idhët. Dukej se ishte shumë i shqetësuar. Kështu ndodh me të saherë që nuk shkon mirë ndonjë problem në ndërmarrjen tonë. Ndofta mendohej të gjente rrugëdalje dhe sipas mendimit të tij unë isha ai që do ta shpëtoja nga këto mendime. Dhe kështu ishte:

— Ku je, more artisti i ndërmarrjes? — Foli i shqetësuar — më le në pritje. — Shtoi pas pak.

— U vonova pak, sa mblodha këto letrat e vizatimit. — Ja ktheva unë, për të justifikuar atë vonesë që, sipas meje nuk ishte e madhe, por ndofta drejtori e quante goxha. Vendosa vizatimet mbi tryezën që ndodhet ngjitur me atë të drejtorit dhe nisa t'i shpalllosja. Në këto momente mundohesha të sillja ndër mend edhe detajet më të vogla që e përbënin projektin tim. Doja të isha sa më i gatëshm për çfarëdo përgjigje që do të kërkohej. Çast vendimtar për gjithë fatin e projektit tim. Prandaj duhej të isha sa më i qartë në atë punë. Mund të them pa e tepëruar se isha përgatitur më shumë se sa kërkohet për të bërë mbrojtjen e ndonjë projektdiplome.

— Çfarë i ke gjithë ato vizatime? — Më pyeti ai pa na shikuar fare as mua as projektet.

— Projektet e linjës së mekanizuar për poligonin e parafabrikateve. — I thashë unë, duke bërë shpalosjen e tyre në mënyrë që t'i kisha gati për të dhënë shpjegimet që mund të kërkonte.

Por, për habinë time, ai ktheu shpinën nga unë e, duke shikuar jashtë dritares, diku në rrugë, më foli:

— Lëre njëherë atë punën e projektit, sot nuk kam hallin e poligonit, as të projektit tënd. Të kam thirrur për një punë tjetër. Unë hoqa vëmendjen nga projektet, ndalova shpalosjen e tyre dhe u përqëndrova te pamja e tij, që dukej shumë alarmante. (Më vonë e mora vesh se ai kishte të drejtë). Për çështjen e estradës drejtori donte të mos kishte asnjë telash. Ai ishte gati të sakrifikonte jo vetëm mua si inxhinier, për disa ditë, por edhe projektin tim. Mjafton që ai të ishte i larë në këtë punë dhe të mos e shqetësonte njeri më në telefon.

— E din si është puna? — Shtoi ai pas një pushimi të vogël që bëri duke thithur cigaren e duke tretur shikimin e tij jashtë zyre.

— Urdhëro! — Ju përgjegja pa ditur çfarë do të më thoshte.

— Duhet të nisesh urgjent për në kantierin e parafabrikimit! Sonte, nesër ose fundja për dhjetë ditë duhet të qëndrosh atje! Shikoje vetë si do të vijë puna, vetëm. . . — Dhe sakaq më zgjati një fletë urdhër-shërbimi.

— Mos kanë propozuar ndonjë variant për mekanizimin e parafabrikateve? — E pyeta unë, duke menduar se ndokush nga punëtorët do të kishte bërë ndonjë propozim për ndonjë ndryshim në projektin

tim, të cilin disa ditë më parë e kisha diskutuar edhe me punëtorët dhe të gjithë kishin folur në favorin tim.

— Atje të rreh mendja ty, more djalë, kurse unë kam tjetër hall sot. — Dhe filloi të më shikonte me vërejtje. Shikoi orën e tij të dorës, pastaj e kontrollloi edhe me orën e madhe që ndodhet mbi tryezën e tij dhe vazhdoi:



— Në kantierin e parafabrikateve duhet të ngrihet me çdo kusht një estradë, kuptomë drejt, inxhinier, është një fushatë me rëndësi. Tani më zuri syri një shkresë që na ka ardhur para ca kohësh nga komiteti ekzekutiv dhe nga bashkimet profesionale. Me çdo kusht këtë herë duhet të dalim në festival. Por e keqja është se në ndërmarrjen tonë nuk kemi regjizor. Prandaj ti do të shkosh të bësh punën e regjizorit. Se si do ta organizosh ti këtë punë, varet nga ti. Unë dua vetëm që të më ngresh estradën dhe të dalësh në festival. Për të gjitha të tjerat mos u merakos. Po më mërzhisin ata të. . . Po ta ngarkoj ty këtë punë se e di që, po të dërgoj një njeri tjetër, do të më mërzhisë ditë për ditë, kurse ti je me aftësi të larta dhe di të manovrosh për çdo të papritur që të del përpara. Jam i bindur se vetëm aftësitë tuaja janë në gjendje të na e heqin qafe këtë telash. Megjithëse edhe ata të komitetit nganjëherë e tepërojnë, dinë vetëm të thonë: «Beni një estradë dhe pikë», pa se si i kemi ne punët aq u bën. Nejse. Është e kotë tani diskutimi për këto punë, se është vonë e duhet të nisesh.

— Unë jam inxhinier dhe nuk kam haber nga arti. E shijoj por, të të them të drejtën nuk di të krijoj. Është mirë që, për këtë punë të bashkëpunojmë me ndonjë artist, me ata të teatrit. Me sa di unë ne kemi një regjizor. . .

Por ai ma ndërpreu fjalën:

— Nuk është punë regjizori këtu.

— Unë thashë kemi një. . .

— Nuk e ke marrë vesh se të gjitha ndërmarrjet i kanë përgatitur grupet teatrale me forcat e veta? Ë? Pastaj unë kam parasysh se ti je njeriu

më i ngritur në ndërmarrje. Jam i bindur se asnjë njeri tjetër nuk ka shije më shumë se ti.

— Por nuk di të krijoj. . .

— Pse? Kujton ti se kam harruar unë që ti more lëje krijimtarie vitin e kaluar?

— Po unë. . . lejen e kam marrë për projektin. . .

— Kam qenë i bindur se ti je nga ata punonjës që asnjëherë nuk u bën bisht detyrave që të ngarkoj, por sot. . .

— Të lutem, më kupto drejtë! Unë kurrë nuk u bëj bisht punës dhe detyrave që më ngarkohen edhe jashtë detyrës sime, sidomos këtyre që kanë të bëjnë me fushata, por kësaj punës së regjizorit nuk ja them fare. Mund ta pohoj me sinqeritet dhe jo për justifikim.

— Provoje njëherë, more djalë!

— Nuk kam ç'provoj. Jam krejt profan në krijimet artistike. Po të jetë fjala për sportin, jam ndryshe.

— Për atë jemi gjithë tifoza xhanëm, po kush është i zoti të na bëjë edhe art, edhe sport. Nejse. T'i lëmë diskutimet se është vonë. Prej teje dua estradën dhe pikë!

Prej atij momenti nuk e zgjati më por më dha dorën dhe unë e kuptova se donte të më thoshte: «Mjaft më dërdëllise, nisu e shko në kantier, bën si të duash vetë, vetëm mua të mos më marrë më njeri në telefon për këtë punë». Unë desha t'i flisja prapë, por bisedën tonë e ndërpreu telefoni. Ata të seksionit të kulturës donin të dinin ç'bëhej në ndërmarrjen tonë me estradën.

— Urdhëro. — U përgjegj drejtori. — Estradën? Po. Tani sa po niset një nga të drejtorisë për të bërë

punën e regjizorit. As mos u merakosni për këtë gjë, se ai është njeri shumë i zoti për këtë punë.

Prej atij momenti e pashtë të kotë të hyja në diskutime të tjera më gjatë, por i dhashë dorën si përgjigje të dorës së tij që kishte disa sekonda që e mbante shtrirë drejt meje.

Mblodha shpejt të gjitha vizatimet dhe letrat me përllogaritjet e shkova në zyrën time. Duke vendosur projektet nëpër raftet për t'i vazhduar më vonë, mendoja: «A thua me gjithë mend drejtori, interesohet për estradën, apo e ka hallin sa të shpëtojë nga ky telash?»

Me këtë mendim në kokën time u nisa për në kantierin e parafabrikateve.

Kur mbërrita në kantierin e parafabrikateve, të parin që takova ishte inxhinier Ismaili, përgjegjësi i kantierit. Ai, kur më pa mua, u kënaq shumë. Kishte kujtuar se kisha shkuar për të caktuar vendin ku do të vendoseshin linjat e mekanizuara.

— Erdhe tamam në kohën që duhej të vije. — Më tha Ismaili duke u përshëndetur për zemërsisht me mua sikur të kishim kohë pa u parë, megjithëse ishim ndarë vetëm dy ditë më parë, kur unë shkova të diskutoja çështjen e projektit.

— Pse? — E pyeta unë.

— Se kemi menduar që në projektin tënd të shtojmë edhe një fabrikë të vogël për prodhimin e çimentos. Një nga ato fabrikat që kanë ngritur shumë ndërmarje të tjera me forcat e veta. Por duhej të kishim projektorganizimin tënd për të parë se ku i ke vendosur mekanizmat e tjera, që të mundim të studjojmë ku duhet ta vendosim fabrikën.

Unë qesha me të madhe.

Inxhinier Ismaili kujtoi se mua nuk do të më

kishte shkuar mendja te fabrika ose për ndonjë diçka tjetër dhe pandehte se unë qeshja me idenë e tij të mrekullueshme. Kurse unë qeshja se për të parën herë shkoja në kantierin e parafabrikimit me një mision që nuk kishte të bënte me aftësitë e mia dhe ende nuk kisha menduar si mund të dilja nga kjo punë me faqe të bardhë. Dhe më e keqja është se, të shkretit Ismail, as që ja pret mendja një gjë të tillë.

— Do t'i lëmë në një anë poligonin tim dhe fabrikën tënde.

— ?.

— Sot kam ardhur për një problem tjetër më të rëndësishëm.

— Si?

— Kam ardhur i ngarkuar nga drejtori për një punë që nuk ka fare lidhje me projektin, as me fabrikën që ke menduar ti.

— Po çfarë problemi tjetër paska drejtori më të rëndësishëm se atë të mekanizimit? Unë çuditem me ju të degës teknike...

I zemëruar pse i thashë se nuk do të merresha me projektin, hoqi dorën nga supi im dhe më pyeti:

— Mos ke hequr dorë nga projekti yt, ai është shumë i mirë!

Unë qesha përsëri, por këtë radhë as vetë nuk e kuptova...

Ai mori zjarr më tepër.

— Projektideja jote për mekanizimin e poligonit është e shkëlqyer, dhe nuk duhet të heqësh dorë kurrsesi nga kjo punë! Ja po ta them seriozisht se, po hoqe dorë ti, do ta vazhdoj unë!

Ismaili fliste shumë i shqetësuar. Pamja e tij

të kujtonte ata studentët që vijnë për të dhënë provim dhe janë shumë të përgatitur po, kur paraqiten para komisionit të provimit, u dalin pyetje nga ato që nuk kanë qenë fare në listën e pyetjeve të provimeve e që janë hartuar e afishuar pak kohë më parë para studentëve.

Unë e kuptova gjendjen e tij dhe e pashë të udhës ta sqaroja.

— Kam ardhur për të ngritur një grup estrade. Edhe ndërmarrrja jonë duhet të marrë pjesë në festivalin e estradave të rrethit. A nuk e ke marrë vesh këtë gjë ti?

— Do të ngresh ti një estradë? — Më pyeti me shumë habi Ismaili.

— Po. — Ja ktheva unë duke u munduar të he-toja cili ishte shkakun që ai habitej aq shumë.

— ?!

— Për këtë problem më ka nisur urgjent drejtori.

Ismaili më shikoi mirë dhe, kur u bind se unë e kisha megjithë mend e bile isha shumë i shqetësuar, vuri duart në ije dhe filloi të qeshte me të madhe.

Ai qeshte, po unë inatosesha. Ai qeshte me misionin tim, ndërsa unë inatosesha: pse të qeshte ai, kur unë isha në pikën e hallit?

— E di si më duket ky shërbimi yt? — Ma ktheu sikur donte të tallej me mua.

— Hë, si të duket, prandaj po qesh kaq shumë?

— Shërbimi yt më bën të kujtoj rastin kur isha dikur i shtruar në spital dhe infermierja ma jepte ilaçin për hapjen e oreksit pasi kisha ngrënë bukë.

— Hape mirë muhabetin, se nuk po të kuptoj.
— Ja ktheva.

— Grupi i estradës sonë është në qytet, more lum byrazeri im!

— Si?

— Po, po! Sonte grupi ynë do të konkurojë në sallën e teatrit të estradës. Ndërsa ti na qenke në një siklet kaq të madh. A jeni në thellësi të punëvet tona ju të drejtorisë, apo nuk i ndiqni fare aktivitetet tona e nuk dini se çfarë bëjmë ne këtej?

Unë shtanga.

— Të lutem, mos u tall me mua, se jam në një hall kaq të madh, sa as drekën e sotme nuk e kam ngrënë akoma e mund të të them se as më hahet pa e vënë në vijë këtë punë. Drejtori kërkon përgjigje nesër në mëngjez me domosdo. Mirë është t'i them diçka qysh sonte. Mos don të tallesh me mua? Të lutem, lëri këto, se nuk e kam kohën tani.

— Ç'estrade do të ngresh, more Esat vëllai? Estradën e ka krijuar me kohë Qamili, ai regjizori që drejtori vetë e ka dërguar në kursin e specializimit që ka hapur shtëpia qendrore e krijimtarisë në Durrës. Qysh ditën që u kthye prej andej ai u dërgua nga ana e ndërmarrjes që të punonte në kantierin tonë si kalldrëmxi, atë zanat që ka patur dhe më parë. Jam i sigurtë se ju e paskeni harruar fare se ne kemi një regjizor në kantier. . .

— Domethënë është e vërtetë se ju keni një regjizor dhe keni ngritur një estradë? — E pyeta unë i rrëmbyer, duke mos u zënë besë veshëve të mi.

— Në don të bindesh për këtë, po të ftoj të vemë bashkë në qytet e të shohim si lozin punëtorët tanë në skenë. — Foli ai duke mbajtur brinjët që i dridheshin nga gazi.

— Ju lutem, mos qeshni! . .

INXHEKSIONI

Që të jesh shëndoshë është gjëja më kryesore në jetë. Por nuk është fjala të gëzosh shëndet personalisht se, po nuk e gëzuan të njëjtën gjë edhe pjesëtarët e familjes, linden telashe. Dua të them që në fillim se në shumë raste, kur sëmuret një anëtar i familjes apo ndonjë i afërt, këputemi të gjithë. I sëmuri vuan fizikisht, ndërsa ne të tjerët shpirtërisht. Por nuk mund të ankohe mi. Me përparimin që ka bërë sot mjekësia, i sëmuri nuk vuan shumë, e keqja është te ne që i shkojmë pas atij.

Pikërisht për këtë dua t'ju tregoj një ngjarje.

...Para pak kohe, m'u sëmur vëllai, sëmundje i thëncin, se ai e kaloi për mrekulli. Mjekët e operuan shumë shpejt dhe ai pas pesë ditësh doli nga spitali. Me një fjalë ai e kaloi të keqen. Por unë u bëra gazi i spitalit atë natë. Dua të them se nuk e kam fjalën për zorrën qorre që hoqi ai, se fundja hoqi nga trupi një tepricë që gabimisht ja kishte ngarkuar natyra. Ah! sa shumë gabime bën nganjëherë kjo natyra, shpeshherë disave u vë pjesë të tepërta, ndërsa disa të tjerëve harron t'u vërë pjesë të tëra. Në këto raste mjekësia bie në hall. Me të parët e ka kollaj, se përdor thikën, sharrën, daltën dhe çekanin,

po të zorshme e ka me të dytët, ndaj këtyre është ende fajtoare.

Kur shkova unë në spital, vëllai qe operuar, narkoza i kishte dalë, sa dhe unë arrita të merresha vesh me të. Nuk është kollaj të të dalë narkoza, ashtu si të ngopin kirurgët nganjëherë; duke pasë frikë se mos u ikën nga salla, megjithëse të kanë lidhur me litar më fort se anijet që ankorohen në port, prapë nuk kanë besim në fortësinë e litarëve. Hej si hidhet burri kur i vë thikën. Pa lëre po lindi nevoja të punojë kirurgu me daltë në kockë. Mos e provofshi në veten tuaj, pa do t'i jepni hak fatkëqinjve. Prandaj kirurgët i dalin së keqes përpara, të ngopin mirë e mirë me eter dhe pastaj sikur në qafë të të presin, në daç me thikë, në daç me sharrë, në daç dhe me gijotinë, t'i s'merr vesh gjë se je bërë i vdekur përpara se të vdesësh. Vetëm jetë s'ke ndërruar ende.

— Të shkuara, vëlla — i thashë me lot ndër sy kur e pashë të shtrirë në krevat e të mbuluar me çarçafët e bardhë si bora. Në krahun e majtë po i vinin serum, ndërsa në të djathtin vazhdonte të merrte gjak.

— Shpëtova, vëlla — tha ai dhe deshi të më jepte dorën e të më përqafoje, por infermierja Kimete nuk e la të lëvizte. Është e palejueshme të lëvizë i operuari në këto raste.

— Mos lëviz, vëlla — tha ajo dhe ja çoi dorën në vendin ku duhej.

Atëhere unë u përkula mbi të dhe e putha në të dyja faqet. Më erdhi keq kur e pashë vëllain në atë gjendje. Nuk isha kurrsesi në gjendje të frenoja lotët.

— S'qenke burrë! — Më tha infermierja. — Vëllai është jashtë çdo rreziku tani. — Shtoi pas pak

ajo. Kurse unë s'mbahesha. Ngashërimi më bënte të qaja. Kisha dëshirë të ngopesha me të qarë.

Dy të sëmurë të tjerë, që ishin në dhomë me vëllain (edhe ata të operuar) u morën me mua. Edhe njëri nga ata kishte të vëllain që i rrinte pranë. Ai kishte tri ditë e tri net që i rrinte pranë.

— Pyete mjekun si ka shkuar operacioni — më tha ai i shëndoshi që qëndronte aty pranë të vëllait.

— Si shkoi operacioni — pyeta infermierën. Atë gjeta më për kollaj.

— Ta thotë mjekja, ajo e ka operuar; unë di vetëm të kujdesem për të. — Tha ajo shkurt, dhe pa e zgjatur shumë doli. Pas tri minutash erdhi me një inxheksion në dorë, e zbuloi vëllain pak dhe ja bëri në të ndenjtur.

— Ku është mjeku, moj shoqe?

— Tani vjen.

Pa mbaruar mirë fjalën ajo, te porta u dha mjekja kirurge.

— Ja doktoresha. Kjo e ka operuar. — Më sqaroi infermierja. Unë u përshëndeta me mjeken.

— Çfarë e keni Asllanin — më pyeti mjekja.

— Vëlla.

— Të shkuara! Tani shpëtoi, për pak do t'i kishte plasur apendisiti. E kuptuam shpejt dhe ja hoqëm. Ka shpëtuar për majë të gjilpërës.

Kështu e kanë për zakon të lëvdohen mjekët; si do që të jetë puna, ata e paraqesin veten shpëtimtarë. Edhe në ndonjë rast, që mos i ndodhtë kujt, kur pas operacionit ka komplikacione e pacienti vdes, ata thonë: «Ne e bëmë tonën, na e sollët vonë» — dhe rrudhin supet për t'u shfajësuar.

Deri këtu çdo gjë shkoi mirë, por ajo më e

keqja dhe që është më kryesorja, për të cilën e pësova.
ndofta pa asnjë faj, është historia e natës.

— Ti do të qëndrosh natën pranë vëllait? — Më pyeti mjekja pasi më dha të gjitha shpjegimet për operacionin.

— Po. — I thashë pa marrë parasysh sakrificat që duheshin përballuar gjatë natës.

— Urdhëro leje-qëndrimin. — Dhe nxori nga xhepi i bluzës një fletë leje dhe stilografin, e plotësoi dhe ma dha.

Tashmë lejohesha të qëndroja njëloj si të tjerët dhe të bridhja, po të kisha dëshirë, edhe nëpër dhomat e tjera.

Deri aty nga mesnata durova, por ama mezi mba-hesha, gjithë ditën e kaluar kisha punuar, në drekë, kur u ktheva në shtëpi dhe mora lajmin e vëllait, as buka nuk më shkoi, veç asaj era e eterit që nxori Asllani më zuri pak. Gjendja ime po rëndohej, lodhja, gjumi dhe narkoza po më mundnin. I sëmuri që kishte krevatin pranë vëllait e kuptoi gjendjen time prandaj deshi të më ndihmonte.

— U këpute — më tha.

— Do të qëndroj — ja ktheva.

— Vëllai është qetësuar ca, prandaj ulu e merr një sy gjumë.

— Ajo do të ishte e mrekullueshme, po nuk kam se ku të mbështetem, nuk e sheh, as karrige nuk ka këtu pranë!

— Dëgjo këtu. — Ma ktheu dhe ma bëri me dorë t'i afrohesha te fytyra.

— Urdhëro! — I thashë dhe i afrova veshin pranë fytyrës, bile sa nuk ja futa në gojë.

— Hajde e shtrihu në krevatin tim!

— Si?

— Bëj kështu si të them!

— Po ti?

— Kollaj për mua. Në dhomën tjetër është një krevat bosh, unë po shkoj atje deri në mëngjez, kurse ti shtrihu këtu.

— Mos vjen infermierja e rojes dhe...

— Infermierja është larguar dhe ka ardhur ai i natës, një meso burrë. Ai i mbaroi inxheksionet dhe nuk vjen më. S'është çudi që edhe ai t'ja këputur gjumit. Hiç mos u merakos. — Kaq më tha pacienti dhe u ngrit e shkoi.

Unë shikova vizitorin tjetër që qe shtrirë në krevat bashkë me të vëllain dhe gërhiste. Ai kishte dy net që e bënte këtë punë pasi i vëllai qe përmirësuar mirë dhe nuk lëngonte, ndërsa unë këtë punë mund ta bëja pas dy ditësh.

Për të qenë sa më i gatshëm hoqa vetëm xhaketën. U mbulova vetëm me batanije dhe rashë. Nuk mbaj mend të kem qëndruar as edhe një minutë zgjuar, sepse gjumi më pat marrë pothuaj pa u shtrirë ende.

Kisha rënë në gjumin më të rëndë, besoj se gjumë më të ëmbël nuk kisha bërë ndonjëherë, por ç'e do. E pësova si breshka te nallbani.

Meqë i sëmuri që më liroi krevatin kishte pasë temperaturë, mjeku i kishte vënë antibiotikë çdo gjashtë orë. Infermieri kishte harruar t'ja bënte në orën dymbëdhjetë dhe qe kujtuar me vonesë, (kështu harrojnë infermierët e rojes shpeshherë). Si kishte bërë gati shiringën kishte ardhur drejt e te krevati ku flija unë. As dritën nuk e kishte ndezur, më kishte zbuluar dhe, që të mos na binte neve në sy harresa (që e bënte kryesisht fajtor), nuk na kishte zgjuar por fap më nguli gjilpërën në të ndenjur. Unë u hodha

përpjetë dhe, po të mos qe ai i shpejtë (vetëm këtu duhet falenderuar) ndofta do të më qe këputur maja në trup e vaj halli ç'do të vente pastaj. Ecë e prano thikat operatore.

— Oooo — bërtita unë.

— Shsh-shsht, mos bërtit, se zgjove pavionin — foli ai pasi e kish hequr gjilpërën nga mishi im, por ama antibiotikun ma kish lënë në trup.

— Ç'më bëre mua, të sëmurë?

— Pse, i shëndoshë je? — Ma ktheu duke dashur të më qetësonte.

Me shpejtësi të jashtëzakonshme vrapova dhe hapja dritën. Infermieri qëndroi si hu në këmbë dhe bënte habi si qe e mundur të kisha fituar aq shpejtësi, kur ai më kujtonte se s'kisha veç gjashtë ditë që isha operuar.

— Po ti, kur je shtruar? — Më pyeti, pasi i hapi sytë (dhe jam i sigurtë se vetëm atëhere u përmend dhe e trembi gjumin edhe ai).

— Unë jam i shëndoshë mor, qëndroj pranë vëllait.

— Ç'e hëngre kot. Aman, mos bën zë më gjatë, se më doli boja — tha duke kafshuar buzët.

Ndërsa infermieri Dane u largua nga dhoma kokulur e i vrarë se nuk e kishte kryer detyrën, unë fërkoja prapanicen dhe mallëkoja të sëmurin Ali që më mbushi mendjen e më futi në kallëpin e të sëmurëve.

— E pe ç'më gjeti? — I thashë atij të shëndoshit që qëndronte shtrirë bashkë me të vëllain dhe nuk po e bënte fare qejfin qeder për atë që më ndodhi mua, vetëm zbardhte dhëmbët e qeshte me të madhe.

— Se mos e hëngre vetëm ti. Ohu sa e kanë ngrënë kështu si ti. Romë për Tomë. Ti s'je as i pari

as i fundit, a derëzi, po shtrihu e të bëftë mirë ajo që hëngre e mos e përsërit më!

— Unë të shtrihem më këtu? Jo, or, jo, se këtë radhë hëngra inxheksionin, radhën tjetër...




PSE, KJO ËSHTË TOKË E RE?

Shefi i seksionit të bujqësisë, shoku Liu (atë e quajnë Ali po kështu e thërrasin për shkurt) më thirrri në zyrën e tij e më tha:

— Dëgjo këtu!

— Urdhëro, shoku shef! — Ju përgjegja dhe hapa veshët të dëgjoja urdhërat; ishte hera e parë që merrja detyra nga shefi. Duhet ta kuptoja mirë urdhërin e tij, nxora bllokun e shënimeve dhe lapsin. Shefi e kuptoi gjendjen time, mori një pozim dhe filloi të fliste mengadalë. Atij i pëlqejnë shumë varësitet që mbajnë shënim urdhërat e tija (këtë e konstatova që në takimin e parë). Dhe unë një i tillë jam. Për shënime jam i vetmi dhe nuk ma kalon njeri. S'prish punë se nuk di të stenografoj. Kjo më falet, sepse jam me dy diploma dhe nuk ka arsye që të mos jem i zoti për shënime.

— Shkruaj! — Foli shefi me ton të prerë dhe vendosi duart nëpër xhepat e palltos së madhe me stof gub. Pastaj qëndroi drejt dhe nisi të mendohej: në këto çaste ai më kujtoi gjelat e detit të fshatit kur thërrasin kllonkat në kullotë e mandej vetë kreksen. Në zyrë pllakosi qetësia.



— Do të shkosh në kooperativën e bashkuar, e di ku bie Mollasi? — Pyeti pastaj dhe hodhi një vështrim nga harta e rrethit që ka varur në mur. E shikoi një herë duke kaluar dorën në pjesën veriore të rrethit. Kaloj pak kohë po nuk po e gjente. Hane fshat, hane Bagdat. Mollasi ndodhet në jugë të rrethit, e shefi e kërkonte në veri!

— Po. Nga Mollasi jam vetë. — Ja ktheva unë që të mos e lija shefin të lodhej për të gjetur ku binte Mollasi.

Shumë mirë, nuk qenka e nevojshme të ta shpjegoj më gjatë në hartë, se, me sa shoh unë, ti e njeh mirë atë zonë.

Në këtë kohë në zyrë hyri përgjegjësi i kadas-trës ose, siç e quajmë ne, shefi i vogël.

— Ja. Tani përgjegjësi i kadastrës do të të njohë me hartën, ti sqarohu mirë dhe nisu urgjent! — Foli me ton të prerë shefi. — Ki kujdes, se do të kontrollosh tokat e reja, mos lërë asnjë copë parcelë pa matur nga ato që janë hapur. Ki kujdes se mos ta hedhin ata të kryesisë e të vënë të matësh toka nga ato që kanë qenë nënkultura vitin e kaluar. — Shtoi shefi për t'u siguruar për punën që po më ngarkonte.

— Mua të ma hedhin? — E sigurova shefin. — Mua, që jam fshatar e bir fshatari, i lindur e i rritur gjyshbabagjysh e denbabaden në Mollas? Hiqe atë mendje, shoku shef! — Ndërsa me vete mendova: «Fat i madh për mua që po shkoj në Mollas! Atë kooperativë unë e njoh më mirë se shefi e kushdoqoftë tjetër, kush mund të ma hedhë mua në Mollas?»

Në Mollas mbërrita aty nga ora dymbëdhjetë e drekës. Në gjithë fshatin nuk gjeta njeri përveç fëmijëve që sapo kishin dalë nga shkolla. Kur i pyeta fëmijët për prindërit e tyre, më thanë se ishin në aksionin e hapjes së tokave të reja. «Për këtë duhen përgëzuar, se aksionin e paskan organizuar shumë mirë» — mendova me vete.

— Ku i hapin tokat e reja? — I pyeta përsëri fëmijët.

— Te Lëmi i Zogjve — m'u përgjegjën ata.

— Po ndonjë nga të kryesisë a ka këtej rrotull?

— Të gjithë i ke atje. Sot është edhe kryetari me ta. — Ma kthyen fëmijët përgjegjen njëherësh.

Mora udhën për në Lëmin e Zogjve dhe, sapo dola në të përpjetën, takova Xha Vebiu.

— Oho, kolopuçi i xhaxhit! Prapë na paske dalë këndeje nga fshati? — Foli xha Vebiu dhe u hodh e më përqafoi sikur kishte kushedi sa kohë pa më parë — na qenke veshun «resmije», mirë, kolopuçi i xhaxhit! Kështu dukesh ma i lezetshëm. Pa hë? Për ku e paske marrë vrapin?

— Për në Lëmin e Zogjve. Më thanë se atje paska shkuar i gjithë fshati për të hapur toka të reja.

— Toka të reja në Lëmin e Zogjve? — Më pyeti me interesim duke ndryshuar në fytyrë e mandej ra në mendime. — Po ku de? — Shtoi ai pas pak dhe më shikoi me habi.

— Po. Kështu më thanë fëmijët, se të mëdhenj nuk gjeta asnjë. — Ja ktheva unë.

— A thue pyllin paskan fillue me prishë? — Foli ai duke më pyetur me shumë kureshtje, — sikur unë dija gjithshka.

— Kur të shkoj ta shoh, po kthehem e të them. — Dhe kujtova se me këtë fjalë do ta qetësoja.

— Jo. Ma mirë po vij edhe unë, se kam vjete që nuk e kam shkelun atë vend. — Ma ktheu dhe pa më pyetur më priu përpara. Në fillim kisha përshtypjen se xhaxha Vebiu nuk do të mundte të ecte por, kur pashë se ai po e merrte të përpjetën, e kuptova se isha gabuar.

Sapo u ngjitëm te Lëmi i Zogjve pamë vargun e kooperativistëve që po punonin ca me bela e ca me kazma. Xhaxha Vebiu vuri dorën mbi sy për të mos ju vrarë nga dielli dhe u kthye nga unë.

— Ti më the se janë tue hapë toka të reja.

— Po. — Ju përgjegja unë i sigurtë.

— Po ku pra? — Më pyeti përsëri.

— Ja atje..... — Bisedën tonë e ndërpreu kryetari i kooperativës i cili me sa duket na kishte parë me kohë dhe na erdhi pranë. U përshëndetëm me të e pastaj hymë në bisedë.

— Me sa duket ke ardhur të matësh tokat e reja?
— E çeli bisedën kryetari.

— Po. — Ju përgjegja unë.

— Ja, shikoi. Këtu punon brigada e katërt. Deri sot kemi hapur shtatë hektarë nga gjashtë që ka në plan kjo brigadë. Ndërsa brigadat e tjera vazhdojnë në parcelat e tjera.

— Si quhet kjo parcela që po hapni?

— Lëmi i Zogjve. — M'u përgjegj kryetari me dashamirësinë e zakonshme që e karakterizon atë.

Unë hapu planimetrinë, gjeta numrin e ngastrës dhe mandej në regjistër gjeta numrin që i përgjigjej planimetrisë. Në regjistër ngastra figuronte kullotë.

— Domethënë ju po ktheni kullotat në toka buke! — E pyeta.

— Po. — Tha kryetari.

— Çfarë kulture do t'i mbillni këtë vit?

— Do t'i kthejmë në ara dhe i kemi planifikuar për grurë.

— Në regjistër kjo parcela është tetë hektarë e pesë arë, a je dakord me këtë apo ta masim përsëri?

— Jam dakord, se edhe vitet e mëparshme kaq ka dalë.

Unë mora shënimet përkatëse. Bëra ndryshimin kadastral nga kullotë në arë. Pastaj i dhashë dorën kryetarit dhe ja shtrëngova fort në emër të shefit të seksionit të bujqësisë dhe në radhë të dytë në emrin tim personal, duke e uruar për brigadën e katërt që

ishte përpara në hapjen e tokave të reja, ndërsa të tjerat, siç më tha kryetari, kishin përfunduar me kohë. Pra ata e kishin realizuar planin në hapjen e tokave të reja.

— Të falemi nderit!

— Pse po e falenderon? — Ma ndërpreu fjalën xhaxha Vebiu.

— Kanë realizuar planin e tokave të reja, o xhaxha Vebiu.

— Ku janë tokat e reja, more birçe?

— Ja, këto që ka hapur brigada e katërt, janë hektarët e fundit. — Ja ktheu për ta sqaruar kryetari.

— Këto janë toka të reja?

— Po.

— Mos, bre birçe, mos e harro kaq shpejt fshatin. Këto toka i kam hapë të reja unë me babën tim në kohë të hyrjetit.

— Epo prapë të reja i quajmë, se vitin që shkoi i patëm lënë pa mbjellur dhe i përdorëm për kullota. Sivjet po i kthejmë në arë, kjo na lejohet. — Ja ktheu përsëri kryetari.

— Mos, bre djema, pse kjo qenka tokë e re? Kjo asht tokë stërgjyshore, more nipçe, po shiko se. ah, kur nuk po vjen një herë ai i madhi i bujqësisë për rrethin tonë e t'i them se nuk ban mirë kështu. Thuaj, more nipçe, të vijë vit për vit e t'ua heqë veshin këtyne të kryesisë që të mos lanë toka djerr për t'i hapë të reja vitin tjetër.

TË FALEM NDERIT USTA!

Usta Kajrafilin e njoha në bufenë e lagjes sonë. Bufeja dhe lokali i këpucëve (që është hapur tani vonë) janë ngjitur, i ndan vetëm një mur. Një ditë, tek pija një gotë birrë në banakun e bufesë, afër meje u ndodh usta Kajrafil. Ai më pyeti:

— Në këtë lagje banon ti?

— Po. — Ju përgjegja unë.

— Ku i rregullon këpucët? — Më pyeti përsëri.

— Ku të mundem. — Ja ktheva unë krejt i shkujdesur për qëllimin e kësaj pyetjeje kaq interesante.

— Shumë keq, djalo — më qortoi ai duke shikuar me kujdes këpucët e mia që rrinin pak të shtrembëra te thembrat. — Ustain e këpucëve duhet ta zgjedhësh dhe të mos e ndërrosh ashtu si ndërron komunalja lokalet e shërbimit. — Shtoi ai.

— Të falem nderit usta! E mora vesh.

Me gjithë mend këpucët më ishin ngrënë ca te thembrat. Vetëm pak. Po atë natë m'u kujtua fjala e usta Kajrafilit dhe qysh të nesërmen në mëngjez vrapova ta gjeja.

Kur hyra në lokal, në vendin e pranimit ishte një këpucar tjetër. Desha t'ja dorëzoja këpucët atij, por prapë ndërrova mendim.

— Ku është usta Kajrafili? — Pyeta atë që ishte në praninë.

— Po zhvishet. Tani vjen. — Tha ai dhe sakaq thirri: — Usta Kajrafili! Hajde se të kanë ardhur klientët qysh në mëngjes.

— Mirë mëngjes usta! — E përshëndeta unë tek po dilte nga dhoma e zhveshjes duke lidhur për-parsen.

— Ohoooo, mirë mëngjes e mirë se erdhe, miku i bufesë — ma ktheu me një nënqeshje të përzemërt — paske ardhur të rregullosh këpucët? — Shtoi ai pas pak. Më dha dorën dhe shikoi këpucët.

— T'i solla, more usta, por...

— Për gjysma apo për bidevi tamëm? — Më pyeti duke shpalosur gazetën.

— Jo, as gjysma as bidevi nuk u vë këtë radhë. Dua vetëm t'u riparoj pak thembrat. — Dhe i tregova vendin e ngrënë.

— Aaaaa. Jo, jo, jo. Këto thembra janë nga të NISH gomës Durrës. Po filluan të hahen vetëm pak, nuk riparohen më.

— Po unë...

— Aman, mos m'u përziej kaq shumë në këto punë! Jam profesionist dhe nuk kam pranuar asnjëherë të nxjerr punë të keqe nga dora ime dhe, kur unë jam i tillë, nuk e kuptoj pse ti don të më për-zihesh në zanatin tim! Unë jam kompetent në këtë zanat, ja di sekretet kësaj pune, ku i djeg e ku i dhemb.

— Sikur nuk janë ngrënë shumë, prandaj po deshe...

Ai qeshi pak me ironi dhe m'u kthye:

— Lëre më mirë në dorën time, do të mbetesh i kënaqur shumë prej meje. Ke për të parë. Edhe

unë do ta lija në dorën tënde një punë që i përket zanatit tënd.

Tani që më preku në sedrën profesionale, m'u duk sikur më gjeti tamëm pikën e dobët. Menjëherë u binda. Kush nuk bindet në të tilla raste!

— Dakord, more mik, si ta kesh qejfin bëni. Vetëm...

— Nesër i ke gati.

— Të falem nderit!

— Ka mundësi të t'i bëj edhe sonte por, që të mos të të dal fjalës, më mirë e lëmë për nesër.

— Mirë u pafshim! — I dhashë dorën dhe desha të nisesha.

— Prit — ma ktheu — do ta pimë nga një kafe bashkë se akoma nuk e kam pirë kafën e mëngjezit.

Pasi pimë nga një kafe të shoqëruar me fërnjet ose siç e quante ustai: «Kafe me meze» unë pagova dhe u ndava me të.

Të nesërmen i mora këpucët. Me sa konstatova unë, që nuk jam aspak kompetent në këtë zanat, m'u duk se takat ishin të reja. Më vonë e kuptova hilenë.

Para disa ditësh djali i kisha blerë një traktor, por ai e kishte zberthyer qysh atë mbrëmje. Sapo erdha nga puna, Gazi më përqafoi e më tha:

— Babi! Leguloje ti tlaktolin, mami jo legulon, ecë babi ecë!


— Ta monton babushi yt. — I thashë djalit dhe vrapova aty ku ishte duke mbledhur veglat. Djali filloi të qante me të madhe.

— Çfarë ke, more xhani i babait?

— Tlaktoli çkeli babi, këpuca babit vrau tlaktoli. — Dhe djali mundahej me të gjitha forcat ta hiqte këmbën time nga pllakat. Unë nuk kuptova asgjë. Punova për nja dhjetë minuta për ta montuar por,

kur bëra provën, traktori nuk lëvizi nga vendi. Dukej se diçka i mungonte. Ose mundet të mos ishte në rregull.

Kishin kaluar disa ditë dhe historia e rregullimit të këpucëve pothuaj se ishte harruar fare.



Ndërsa traktorin e mbanim vetëm për bukuri mbi tryezë.

— Babi! Leguloje tlaktolin — më tha djali një mbrëmje tek rrinim në kuzhinë dhe djali po mund-
dohej ta bënte të ecte.

Mora traktorin ta rregulloja. E zmontova përsëri dhe e montova me shumë kujdes. Kur mbarova së vëni të gjitha pjesët nëpër vendet e tyre fillova ta shihja me vërejtje atë vendin që më mbeti bosh. Konstatova se aty mungonte një ingranazh.

— E gjeta, e gjeta, e gjeta — bërtita me të madhe dhe e lashë traktorin ashtu si ishte e vrapova te këpucari.

— Hë, t'u prishën këpucët e tjera tani? Me siguri të paskan pëlqyer ato të parat. — Më tha Kajrafili pa hapur unë gojën akoma.

— Jo. Sa për këpucët të falem nderit shumë usta! Më ke bërë një punë shumë të mirë. Por sot kam ardhur për një hall tjetër, që edhe ky ka lidhje me këpucët.

— Hë, t'u prishën përsëri takat?

— Këto taka kaq të mira më kushtuan, shumë, more xhani i vëllait, më kanë nxjerrur jashtë përdorimit një traktor.

— Një traktor? — Foli i shqetësuar ai. — Si është e mundur? — Shtoi pas pak.

— Në thembrën e atyre takave që ke hequr ti ka qenë ngulur një ingranazh traktori. — I thashë unë shumë i shqetësuar e duke m'u dridhur zëri aq, sa ustai me zor e mori vesh.

— Ke të drejtë — tha ai pasi u mendua pak — edhe unë pashë diçka në atë thembrën që hoqa atë ditë. Por tani. . .

— Hë, bravo të qoftë, usta! Të kujtohet ku i ke

hedhur? Vetëm më trego ku i ke hedhur, se do të vete t'i kërkoj derisa t'i gjej. Dua të gjej atë takën time, ku ishte ngulur ingranazhi.

— Ato taka janë hedhur me mbeturinat. — Ma ktheu.

— Sa mirë që e mban mend. Më trego tani ku i ke hedhur, se unë do të vete t'i shpërndaj e të kërkoj derisa ta gjej atë ingranazhin. Takat nuk kanë se çfarë më duhen. — Ja ktheva i gëzuar, por gëzimi im kishte qenë i parakohshëm.

— I ka marrë karroca e komunales. Nuk besoj t'i ketë hedhur shumë larg se s'e ka bërë zakon këtë komunalja, por ne jemi të rinj në këtë lagje dhe nuk e dimë qendrën e grumbullimit të plehrave.

Pas kësaj bisede u ktheva në shtëpi me dëshirë të thyer dhe me shpresa krejt të humbura për ta rimëkëmbur atë traktorin e Gazit.

Gazmendin e gjeta duke u munduar ta bënte traktorin të ecte por gjithë përpjekjet e tija dhe të miat qenë pa sukses. Kur më pa, e kuptoi menjëherë që nuk e kisha gjetur dhe sikur u dëshpërua edhe më tepër.

Pothuaj se kishin kaluar muaj, por historinë e ingranazhit në ende nuk e kishim harruar. Traktorin e vjetër e kishim vënë për zbukurim mbi një tryezë dhe, saherë e shikonim, na shkonte ndër mend ajo ngjarja aq misterioze që na nxori jashtë përdorimit një traktor kaq të bukur.

Siç e thashë, unë nuk jam këmbështrembër, por thembrat e këpucëve përsëri filluan të më haheshin. Vendosa t'i dërgoja për riparim. Një ditë i mbështolla me gazetë dhe porosita vajzën t'i çonte tek ustai. Nuk desha të shkoja vetë se kisha frikë mos ngulte këmbë të më ndërronte gjithë tabanin. Veç asaj tash-

më e shikoja të paarësyeshme të shkoja vetë sepse ustai nuk besoja t'i bënte kujt punë të keqe. Mua në asnjë mënyrë. Prita të kthehej vajza. Doja të dija se çfarë i kishte thënë.

Kur u kthye vajza e më shpjegoi, doli ajo që kisha menduar. I kishte thënë se thembrat duhej të viheshin të reja. Sa për gjysma nuk i kishte thënë gjë fare.

Më vonë e kuptova pse ndodhte kjo.

— Kur të tha t'i marrësh? — E pyeta vajzën.

— Nesër, më tha të shkoj pasdite.

— Merri ti, se unë do të jem në një mbledhje.

Të nesërmen, për shkak të asaj mbledhjeje që zgjati më shumë se sa duhej të zgjaste, u ktheva pak vonë. Sapo shkela në prak të derës, vajza më priti shumë e gëzuar. E kuptova se diçka donte të më tregonte, por kurrë nuk më shkonte mendja tek ingranazhi.

— Babi — foli e gëzuar ajo. — Më duket se është gjetur ajo vegla e traktorit. Në thembrën që ka vënë këpucari është një vegël si ajo që ke bërë ti në skicë. — Me shpejtësi të madhe vrapoi e më solli këpucët. Çfarë të shihja?! Në mes të takës, që gjoja ishte vënë si e re, dukej i ngulur një ingranazh. Në fillim kujtova se mos ndofta ustai e kishte gjetur ingranazhin dhe donte të më bënte surprizë mua por, kur analizova mirë takat, konstatova se këpucari këtë herë më kishte shitur për të reja po ato takat, që nguli këmbë të m'i hiqte radhën e parë. Bile as i kishte mballosur fare.

Hoqa ingranazhin dhe e montova te traktori. Traktori u vu në lëvizje.

Desha të shkoja t'i thoshja por e lashë për më vonë. Një ditë, kur e takova në bufe, i thashë «TË

FALEM NDERIT, USTA» ma gjete ingranazhin. Pas-
taj shtova:

— Ama kjo qenka puna me ndërmjetësat, që i
njohin nëpër bufe? Jo, për nder, unë kurrë nuk bëj
më punë me ndërmjetësime. Lëre që me miq jo e jo!
Ustai uli kokën. . .

NJË PUTHJE JO E ZAKONSHME!

Maqina ndaloi mu përpara stallës së derrave.
— Më tutje nuk po e provoj. — Tha shoferi dhe e shoi motorin.

— Jemi larg nga zyrat e kryesisë. — I folëm ne.

— Nuk e shikoni se çfarë plehra janë hedhur në rrugë? Ato janë më të rrezikshme se balta. Sikur edhe traktor të jetë, ka rrezik të mbetet brenda, jo më kjo maqina ime.

— Ecë, ecë edhe ca. — Shtova unë që e komandoja shoferin.

Shoferi e ndezi përsëri motorin dhe maqina sikur kërceu me forcë e pastaj u zhyt menjëherë në një batak të çuditshëm.

Motori u shua vetë.

E kuptuam se nuk ecej dot asnjë metër më tutje.

— Tani bëni si të doni. — Foli i dëshpëruar shoferi.

Morëm çantat dhe zbritëm për të vijuar rrugën drejt zyrave të kryesisë. Që në hapat e para u zhytëm në atë baltë të çuditshme e cila në dukje të linte të dyshoje se nuk bënte pjesë në asnjë nga kategoritë e tokave.

— Si nuk e paskan pastruar këtë baltë? — I fola shoqëruesit tim. — Ky është agronomi i frutikulturës në komitetin ekzekutiv dhe sot ka ardhur me mua si përfaqësues i seksionit të bujqësisë.

Më kot prita të më jepte përgjigje sepse ai po qeshte me të madhe. Qeshte me pyetjen time.

Unë u bëra gati t'i flisja por një zë i frikshëm, që erdhi nga thellësia e stallës së derrave, më detyroi të hiqja dorë nga vendimi që kisha marrë.

— Heheeej, ju atje! Kujdes nga derrat! Gigigic, gigigic. — Foli me një ton paralajmërues ai duke bërtitur me gjithë fuqinë që kishte duke vrapuar pas derrave me një stap të madh në dorë.

Duke tundur stapin ai u kanosej derrave, e herë-herë nuk kursente as goditjet në kurriz të tyre. Por derrat nuk donin t'ja dinin. Me një fjalë nuk u bënte as tërt veshi.

Ku pyet derri në të tilla raste.

Ne u bëmë gati të largoheshim por ishte e kotë. Çdo përpjekje për të ikur, ishte pa rezultat pasi ishim zhytur deri në gju në atë lloj balte të papërcaktuar teknikisht.

Derrat vrapuan e u dendën brenda. Për çudinë tonë i ngrinin kokat lart dhe i tundnin në drejtimin tonë. E kuptuam se po na kërcënoheshin. Ktheva kokën të kërkoja ndihmën e agronomit. Si njeri i marrë me bujqësi — thashë — ndofta duhet të dinte se si duhet të mbrohesh në të tilla raste. Por çfarë të shihja? Ai kishte mundur ta kalonte baltën, ishte futur brenda në maqinë dhe bërtiste:


— Kthehu mbrapsh, se të shqyen derrat!..

— Aman! — I thashë me ton lutës. — Së paku më mbaj çantën që të mos më damtohet! Në çantë kam të gjitha kontratat e standartet e mollëve si dhe

gjithë korrespondencën e shkresave zyrtare që kemi këmbyer me kryesinë e kooperativës. Po më ra në baltë kjo, ka rrezik të më dëmtohet gjithë ky dokumentacion me rëndësi ekonomike për ndërmarrjen time.

— Lëre çantën, more, po kujdes kokën!

— Ke hak ti, se mbron interesat e bujqësisë. —
Ja ktheva.



— Lëri interesat, po ruaj veten! — Ma ktheu me të shpejtë.

Fjala e tij me atë ton këshillues më bëri t'i hidhja një sy hetues ambientit përreth.

— Vetëm disa metra më ndanin me derrat.

— Ruaju se të shqyen, o ditëzi! Gic, gic, du, du.

— Bërtiste me maksimumin e zërit të tij bariu.

«JETA IME NË RREZIK», mendova dhe në moment e përfytyrova veten të copëtuar prej tyre. M'u duk se u bëra «Theror» i asaj dite të kobshme. Isha ca krenar, se i vetmi unë po bëhesha heroi i ndërmarrjes së frutave e zarzavateve për të mbrojtur interesat e ndërmarrjes. Isha i pari përfaqësues që nuk kisha pranuar të shkelej aspak standarti i mollëve (për këtë isha ngarkuar) që ishte aprovuar nga ndërmarrja. Dua të them se unë kam meritë edhe për standartin të cilin vetë e kisha sajuar, dhe më vonë e modifikova aq bukur, sa gjithë ndërmarrja ra rehat.

Derrat m'u afruan shumë pranë. U bëra gati të futesha në dyluftim me ta por e pashë veten shumë ngushtë. M'u duk se isha një njeri krejt i çarmatosur në mes të një ushtrie që edhe nëpër dhëmbë ka armë nga më modernet, të cilat qëllojnë gjithnjë vetëm në shënjë. Dhëmbët e derrave më dukeshin mu si plumba të telekomanduar.

«Bah! — Thashë me vete. — Derra kaq të mëdhenj e të shëndoshë si këta nuk kam parë ndonjëherë! Ah, sikur të ndodhej prezent drejtori e të shihte me sytë e tij se në çfarë rrethanash po e jap jetën për të mbrojtur interesat e ndërmarrjes dhe kapriçiot e mia!»

Që të mos e shikoja veten duke u shqyer, mbylla sytë. Ashtu symbyllur mendova:

«Ah, sikur kjo të ishte vetëm një ëndërr!»

Në moment m'u duk sikur isha në mes të magazinës së mollëve në ndërmarrje dhe para meje ndodhej varri im i mbuluar me lule molle të porsaçelura. Anësh trupit më kishin rrethuar me mollë. Sa mirë! Shyqyr që jam përfaqësuesi i mollëve!

Shenjë e keqe për mua varri. Por ai sikur m'u zhduk dhe e pashë veten që ndodhesha në korridorin e zyrave të ndërmarrjes, pikërisht përpara zyrës së drejtorit. Por jo i gjallë. Isha një monument që më kishte ngritur drejtori për të përjetësuar sakrificën time. Një përmendore shumë interesante, megjithëse m'u prish pak qejfi. Më mbeti ca hatri me drejtorin i cili gjithmonë më ka mbajtur pranë e i ka përkrahur propozimet e mia duke u bërë ndonjë ndryshim. Ndërsa përmendoren time e kishte ndërtuar pa asnjë ndryshim, duke vënë bustin tim me një laps në dorë që mundohesha të mbrohesh nga derrat. Pak më tutje dy derra të shpuar tejpertej me laps dhe disa pjesë të trupit tim të copëtuar prej tyre.

«Sa keq! — mendova. — Drejtori ka bërë gjithë ato ndryshime në relacionet e mia për mollët. Tani, që rashë heroi i mollëve, nuk më bëri mua asnjë ndryshim. Me gjithë mend unë rashë duke luftuar me derrat dhe ata ma copëtuan trupin tim të njomë, por çfarë e keqe i vinte drejtorit sikur të vente kundra meje jo derra por luanë?»

U bëra gati t'i lutesha drejtorit për këtë, por një krismë pushke e zbrazur nga kooperativistët për të dhënë alarmin më përmendi.

Kur hapa sytë, e pashë veten ballë për ballë me derrat. M'u prenë të gjitha fuqitë. Doli ëndrra pa kaluar asnjë minutë. Çanta më shpëtoi nga dora tamëm atëhere, kur derri i parë ngriti këmbët e para dhe u hodh mbi mua. Do të isha rrëzuar por isha

futur më thellë se një shtyllë elektriku në batak.

Për çudinë time dhe të gjithë atyre që e shikonin këtë skenë, derri vuri thembrat e tij të forta mbi duart e mia të buta, të cilat i kisha ngritur lart në shënjë dorëzimi duke menduar se ndofta edhe derrat kanë intuitën e ariut, pasi i rراسi pak thembrat në duart e mia, çukiti pak noçkën në ballin tim dhe, duke më përkëdhelur me mustaqet e forta, ma vuri noçkën mu në buzë. Pas këtij veprimi u ul poshtë dhe kafshoi çantën, e ngriti lart atë dhe u bë erë. Iku.

Mu sikur ishin të stërvitur prej kohësh, të gjithë derrat e tjerë bënë veprimin e atij të parit.

Rreth batakut qenë grumbulluar shumë kooperativistë, të llahtarisur për rrezikun që më kanosej, kërkonin të gjenin forca për të më shpëtuar nga vdekja e sigurtë.

Ai fshatari i armatosur u bë gati të qëllonte një për një të gjithë derrat që do të më afroheshin mua por, duke menduar se mund të më dëmtonte, kishte hequr dorë nga ky vendim.

Kur derri i fundit mbaroi punë me mua dhe u nis për rrugë, atëhere e kuptova se ata më kishin puthur e më kishin shtrënguar dorën.

Derrat dolën nga balta dhe shqyen çantën.

«Hallall çanta, kur më falën jetën.» — Mendova.

Por mrekullia ishte më vonë.

Derrat nxorën nga çanta vetëm dosjen me kontratën dhe korrespondencën që kisha bërë me kryesinë e kooperativës për mollët. Dosjen e grisën dhe filluan ta hanin, kurse njëri nga derrat kapi të hante standartin e mollëve. Atij, duke dashur ta kapte e të ikte, ju fut koka në atë vrimën e madhe. U

ngrit në këmbët e prapme. Standarti u shfletua dhe ju var atij si reklamata e frutave që varin nëpër pazar.

Dua të shënoj se këtë model unë e kam sajuar **vetë**. Është një lloj kartoni me tri vrima të madhësive të ndryshme. Ato mollë që nuk kalojnë nga vrima e parë, janë të kualitetit të parë, ato që kalojnë nga vrima e parë por nuk kalojnë nga e dyta, janë të kualitetit të dytë. Ato që kalojnë nga e para dhe e dyta por jo nga e treta, janë të kualitetit të tretë. Ndërsa ato që i kalojnë të tria vrimat janë jashtë standartit.

Këtë metodë e kisha shpikur unë para disa kohësh dhe e paraqitja si një nga shpikjet më të çuditshme. Në çdo mbledhje që bëhej flitej për punën time të merituar, se vetëm me këtë metodë arritëm t'ua mbyllnim gojën ankesave të kooperativave bujqësore dhe fermave. Prej asaj dite u prenë pretendimet e tyre për klasifikimin e mollëve.

Derrat ma falën jetën e më përgëzuan por ma nxorën sekretin e ndërmarrjes.

Këtë nuk e desha. Më mirë ta kisha dhënë jetën në batak se të nxirrja sekretin e ndërmarrjes.

Kur u ngrit në këmbët e prapme derri që kishte kartonin në qafë, ai u shpalos dhe në fund të tij lexohej: «STANDARTI I LAKRAVE».

Të gjithë e kuptuan se ne si ndërmarrje tregëtare kishim përdorur standartin e lakrave në vend të atij të mollëve.

E qeshura filloi menjëherë dhe sundoi gjithë atë territor.

— Po ju mos qeshni, more burra, po hajdeni e më ndihmoni! — U fola kooperativistëve që ishin grumbulluar e qeshnin rreth derrit.

— E kush je ti, që je zhytur në bërsi të mo-

llëve? — Foli njëri prej tyre e që me sa kuptova unë duhet të ishte kryetari.

— Jam përfaqësuesi i NTSHFZ-ës. — Ua ktheva shumë krenar duke menduar se do të vraponin menjëherë drejt meje se kishin kohë që më kërkonin.

— Po ç'drejtë të çoi të rrasesh kaq thellë në mollët e kalbura?

— Pse, more, mollë të kalbura janë këto?

— Po.

— Kurse unë kam ardhur t'i kontrolloj nga ana e kualitetit dhe çfarë standarti kanë, more shokë, po ju. . .

— Meqenëse ke ardhur kaq vonë, duke mos respektuar asnjë nga pikat e kontratës, shikoi tani pas varrosjes së tyre dhe bëju ekspertizën. Po munde, përcaktoje se çfarë kualiteti kanë. — Ma kthyen ata pasi më nxorën prej aty ku isha zhytur.

Vetëm atëhere e kuptova se balta në të cilën isha zhytur ishte kompozimi që kishte dalë nga kalbja e mollëve të patërhequra nga ana e ndërmarrjes tregëtare. Ato tani përdoreshin si ushqim për derrat, që i kishin hak se ishin rritur aq shumë. Si derra të rritur me mollë! Prandaj kishin pasë të drejtë që bënë gjithë atë rrugë për të ardhur të më puthnin.

Ndërsa unë kërkoja ta krahasoja veten me atë bustin që pashë nëpër ëndërr përpara zyrës së drejtorit, kooperativistët ishin grumbulluar rreth meje dhe qeshnin me të madhe.

— Po çfarë standarti qenka ky? I mollëve apo i lakrave? — E pyeti njeri nga kooperativistët agronomin e frutikulturës. Unë mendova se ai do të më mbronte mua, por ndodhi e kundërta.

Aj e mori kartonin nga kooperativisti dhe ma

vuri në qafë mua. Për çudi kokën time e përshkoi pa takuar fare vrima e parë.

— Ndofta është standarti i kokës së NTSHFZ-ës, që i dashka mollët më të mëdha se kokën e vet, të cilën nuk e paska as të kualitetit të parë pa le. — Foli agronomi i komitetit.

— E shikoni sa dëme i keni sjellë kooperativës sonë, duke i lënë të kalbeshin. — Foli kryetari i zemëruar.

— E, o derëzi, se mos u lodhët shumë duke i prodhuar mollët. Të keqen e heq unë që i shes. Pa juve? Juve ju janë rritur vetë. Puna është t'i shesësh.

— Hej bela — thanë kooperativistët — më zor për t'i shitur se sa për t'ja rrëmbyer natyrës! Punë të madhe bën kjo NTSHFZ-ja.

METAMORFOZA E SHOKUT KAJRAFIL!

Nuk ka ndonjë evidencë që të them me saktësi sa herë na ka mbledhur shoku Kajrafil e na ka folur «për rritjen e ndërgjegjes në punë». Është turp për mua të them shifër, sepse mund të raportoj ndonjë numër më të vogël nga fakti. Por duhet pranuar se së paku nja katër herë e gjysmë në muaj kjo punë bëhej. E them këtë numër pasi një ditë në javë ishte e zakonshme «këshilla» e tij. Por ndofta kishte javë që ne mund të merrnin edhe dy herë leksione të tilla.

Të them të drejtën, më erdhi keq pse ngjarja që shkruaj ndodhi me shefin tim, por ja që fatkeqësisht kështu ndodhi:

Shefi erdhi në zyrë hundë e buzë varur. Përplasi derën dhe, pa na përshëndetur fare me atë mirë-mëngjezin e «mjaltët» si zakonisht, shkoi te vendi i punës së tij në krye të zyrës; hodhi çantën mbi tryezë, rregulloi atë jastëkun e pambuktë që mban mbi karrige dhe u ul. Pastaj na hodhi një vështrim qortues të gjithëve duke shikuar punët që kishim nëpër duar. Mori receptorin, formoi një numër dhe filloi të fliste:

— Alo! Desha pak Manushaqen! Po, i shoqi jam, Kajrafil.

Ndërsa priste që t'i përgjigjej Manushaqja, shefi nxori një «ohf» të zgjatur e të stërmunduar. Ne shikuam njëri-tjetrin dhe e kuptuam se shefi kishte një hall të madh, i cili i kishte sjellë këtë dëshpërim; ishim gati të merrnim pjesë në dëshpërimin e tij por ai vijoi:

— Hë, Manushaqe! E takove? Ashtu? Cfarë të tha? Jo! Sa keq!..

Kur uli receptorin, ne u bëmë gati ta pyesnim për të mësuar shkakun e zhgënjimit të tij por nuk na la radhë telefoni. Zilja ra menjëherë, sapo shefi e vuri receptorin mbi aparat.

— Alo! Po, Kajrafili jam! Hë, more Harallamb, se më plase! Si? Ashtu? Domethënë është e sigurtë. Të falem nderit shumë e ta paça borxh derisa të vdes! Ja tani po vij. — Dhe fytyra e shefit pësoi një ndryshim. Ai u çel më shpejt se qielli në pranverë që kthehet nga shiu me erë në diell të nxehtë. Nuk foli fare, por u ngrit e doli me të shpejtë.

Gjatë kohës që shefi ishte larguar pa na thënë se ku ndodhej, Manushaqja — e shoqja — vazhdon-te ta kërkonte në telefon herë pas here.

Pas dy orësh erdhi. Ishte po me atë nurin e tij të qeshur, me sy të çelur e të pastër që i vetëtinin sikur të ishin drita të ndezura. Mezi priti të ulej. Mori receptorin, formoi numrin dhe:

— Alo! Manushaqe, ti je? Mbaroi. Po, po. I mbarova të gjitha formalitetet. Vdiq edhe kjo punë... .

Vuri receptorin në vendin e tij dhe u kthye nga ne:

— Më thirrni edhe ata dy nëpunësat e tjerë në zyrën matanë! — Foli me një ton të butë e të ëmbël.

Ne i thirrëm por ata sepse u vonuan ca.

— Ku ishit? — U bërtiti shefi gjithë autoritet, sapo ata shkelën në portën e zyrës.

— Atje... në zyrë...

— Kur ju thërras unë, të lini gjithshka dhe të jeni këtu jo më vonë se tridhjetë sekonda. Herë tjetër, për të mos humbur minutat e nëpunësave të kësaj zyre, nuk do të vijmë t'ju thërrasim, por vetëm do të trokas në mur me rrigë dhe, pa hequr unë rrigën apo tamponin nga muri, ju të trokisni në portën e zyrës sime. Dakord? — Foli shefi duke mbajtur një qëndrim shumë serioz. Mimika e tij përsëri pësoi një ndryshim.

— Pra — filloi të fliste shefi — ju thirra t'ju komunikoj se nesër, me fillimin e muajit të ri, shefi juaj shkon me leje. Ju thirra t'ju ndaj detyrat për kohën që unë...

— E rregulluat punën e kabinës, shoku shef? — E pyeti Namiku, që e ka zakon të qëndrojë gjithmonë në krahun e djathtë të shefit.

— Ç'kabinë, more Namik? Ti e more vesh si u bë puna e kabinave sivjet këtu në ndërmarrjen tonë. U ngritën punëtorët si të tërbuar dhe... — Foli shefi duke tërhequr buzët në drejtim të faqeve.

— Po si do t'ja bësh? Ti je mësuar t'i kalosh pushimet çdo vit në plazh? — Ja ndërpreu fjalën Namiku duke i qarë hallin.

— Hëmmm — qeshi shefi me buzë të mbyllura dhe shtoi:

— Rregullova dhomë në vilë.

Namiku zgjati krahun drejt shefit dhe dashje pa dashje ne e pamë që i shtrëngoi dorën. Pastaj shtoi:

— E ke shok të fortë atë Harallambin. Ah, sikur edhe unë të kisha një të tillë...

— Pra — vazhdoi shefi, duke ja lënë fjalën përgjysmë Namikut — për pesëmbëdhjetë ditë ju do të punoni pa mua. Të gjitha ato probleme të cilat janë jashtë kompetencave dhe kapacitetit tuaj, do t'i mbani në evidencë e pastaj të m'i raportoni kur të kthehem. Nëse keni ndonjë problem shumë interesant, desha të thoshja urgjent, t'ja mbathni e të vini në plazh! Jam në vilën numër trembëdhjetë.

— Mos! — Foli Namiku dhe u hodh përpjetë sikur ta kishte pickuar ndonjë grenxë apo mizë blete.

— Ç'pate? — E pyeti Kajrafili i habitur nga ky shqetësim i Namikut.

— Thonë se ky numër është ters. — Pohoi Namiku.

— Unë jam i çliruar nga paragjykimet. — Ja ktheu Kajrafili, duke e shikuar me hundë e buzë të përveshura për paudhësinë që i ndolli Namiku. I erdhi zor që një vartës po i ndillte tersllëk.

— Puna do të vejë shumë mbarë — vijoi shefi. — Nejse. E kemi fjalën te detyrat. Ju këshilloj të jeni të rregullt, të mos sorollateni, të mos vini vetëm sa për t'u gjendur në punë gjatë orarit zyrtar, por për të punuar. Porosinë e fundit që kam: në këmbën «time» për këtë periudhë do të jetë shoku Namik. Ta doni, ta respektoni, ta dëgjoni njëllor si mua. E them këtë se gjithmonë do t'ju flasë në emrin tim. . . — Përfundoi porosinë shefi dhe i hodhi një vështrim Namikut duke i kaluar dorën në mes të shpatullave. Dy nëpunësat e zyrës matanë dolën, ndërsa ne hapëm dosjet tona dhe u zhytëm në punët, të cilat i kishim ndërprerë për gati një orë për të marrë «porositë» e shefit.

Kur mbetën vetëm Kajrafili dhe Namiku diç

biseduan, pastaj shefi mori receptorin, formoi një numër dhe foli:

— Alo? Stacioni meteorologjik? Jam Kajrafili, Kajrafil Molla. Kush? Aaaa, ti je, moj Luleshtrydhe? Po si u gjete tamam tani që të dua unë? Dëgjo: mua më duhet parashikimi i kohës për dyjavorin që vjen. . . Pse e dua? Hë! Pyetje interesante! Kemi disa punë në terren të hapur dhe duam të dimë si do të jetë koha. Na duhet ta kombinojmë punën me kohën, se mund të na zërë shiu e të na priten punët në mes. Kur e duam? Po të jetë e mundur sot pasdite. Falemi nderit! Mirë u pafshim!

Pas kësaj bisede shefi u largua nga zyra. Më vonë morëm vesh se kishte shkuar në zyrat e komunales për disa kontraktime të plazhit dhe u vonua mjaft. Një gjysmë ore para se të mbaronte orari i punës, shefi erdhi përsëri në zyrë. Pak para tij erdhi nëpunësja e meteorit, Luleshtrydhja, e cila solli buletin e kohës.

Ishte e jashtëzakonshme ardhja e një buletini të tillë në zyrat tona. Filluam të mendonim pse duhej ky buletin se, praktikisht edhe breshër sikur të bjerë, ne s'ka çfarë të na pengojë në zyrë. Punë në terren të hapur ndërmarrja jonë nuk ka. Atëhere pse duhet kjo?

— Do ta ketë kërkuar për të ditur si do ta kalojë plazhin. — Tha Donika, njëra nga nëpunëset, e cila është edhe kryetare e komitetit profesional të ndërmarrjes.

— S'është e mundur. — Ja ktheu Kujtimi.

— Ja kështu siç thotë Donika është. — Pohoi Gazmendi, dhe mori një letër të bardhë e shkroi:

«Data 1,2,3 kohë e mirë. Data 4,5,6 vranësira të dendura dhe erëra nga jugu. Data 7,8,9 shi me erë

të fortë, sidomos në bregdet, data 10,11,12 shi, breshër dhe erëra shumë të forta nga Adriatiku. Data 13,14,15 ciklone të forta, temperatura do të jetë nga 28^o deri 32^o celsius. Marrë me telefon.»

Gazmendi e përpiloi këtë lojë duke ndryshuar plotësisht atë çfarë shkruhej në buletin, na e lexoi neve dhe e vendosi mbi tryezën e shokut Kajrafil, kurse buletinin e futi në sirtarin e shokut Kajrafil.

Dhjetë minuta para se të mbaronte orari zyrtar erdhi shefi. Ai ishte gjithë gëzim. Sytë i shkuan te letra mbi tryezë. Në fillim i qeshi fytyra, pastaj ai filloi të zverdhej e të nxihej. Me një fjalë mori krejt atë pamjen e buletinit që lexonte. Kur e mbaroi së lexuari, zuri kokën me dorë dhe ra në mendime. «Po tash?» — përshpëriti nëpër dhëmbë, dhe shfryu duke nxjerrë ajrin me një presion mu sikur shfrynte ndonjë kompresor.

«Gjithshka e kotë», foli pas pak. «Na, do të kisha bërë plazh». — Foli me të madhe duke treguar bërryllin nga ne. Pastaj shtoi:

«Ja çfarë do të thotë t'i dalësh së keqes përpara». — Këto i tha pa i vënë rëndësi faktit që ne ishim aty e tashmë po kuptonim se çfarë po ndodhte me të. Kur na pa, diç deshë të na thoshte por në derë u dha drejtori. Ai i foli:

— Këtu qenke ti, Kajrafil? — Tha drejtori dhe i shkoi pranë.

— Ku do të isha gjetkë, veç zyrës, shoku drejtor. — Ja ktheu shefi gjithë turi. Dukej se ishte bërë pikë e vrerë.

— Dëgjo këtu! — E paralajmëroi drejtori.

— Urdhëro! — Foli Kajrafil sikur t'i ishin mbytur gjemitë.



— Na kërkohen nga dikasteri formulari i realizimit të planit, si global. Ai i rendimentit, i kostos, i investimeve i... Para se të largohesh caktoju detyrat se kush do të merret me këto punë, unë diku do të shkoj dhe ka mundësi të mos takohemi më, por të uroj pushime të mbara!

— Shoku Drejtor! — Foli shefi dhe filloi të qeshëj në fytyrë.

— Urdhëro!

— Kam diçka serioze. — Ja ktheu shefi që po e shihte se po i qeshte fati.

— ?.

Shefi na bëri me shenjë të dilnim jashtë.

— Të kam thënë, shoku drejtor — vijoi shefi kur ne kishim dalë nga zyra — se këta nëpunësat e mi nuk janë as për të nxjerrë qimen nga qulli. Me përjashtim të Namikut, këta të tjerët nuk ja thonë fare. Jam unë që e bëj punën e tyre. Jam unë që e mbaj ndërmarrjen mbi shpatulla, jam unë që u bëj ballë të gjithave... .

— Askush nuk e vë në dyshim këtë, Kajrafil! — Ja ktheu drejtori.

— Atëhere si ma lejon ndërgjegja mua ta lë ndërmarrjen në këtë gjendje? Si mund të largohem unë, kur dikasteri kërkon këto gjëra? Si... .

— Po... ti... si — kur ke rregulluar edhe një vilë? Si do të bësh me të? — E pyeti drejtori dhe menjëherë krijoi të tjera opinione për Kajrafilin.

— Ja kontrata, le të shkojë ndonjë punëtor e të bëjë qejf, shoku drejtor. Kurse unë këtë herë do të zhytem nëpër dosje për të bërë formularët. — Foli shefi duke nxjerrë nga xhepi kontratën e vilës, të cilën, pasi e shpalosi, e vendosi mbi tryezë përpara drejtorit.

— Si?! Ti do të anulosh lejen? — Foli drejtori i habitur.

— Po. — Pohoi shefi gjithë pompozitet. — Vetëm kujdesu që të më rregulloni një vilë ose fundja një kabinë për pesëmbëdhjetëditorin tjetër. Ju e shikoni pse po e bëj këtë. — Shtoi shefi duke u krenuar përpara drejtorit.

— Për atë mos u mërzit, le ta marrë lejen ndonjë që është planifikuar në periudhën tjetër dhe të nisët. Me një fjalë të bëni këmbim. — E qetësoi drejtori. — Po nuk u rregullua kështu, po interesohem unë të bëjmë një këmbim me ata të komunales. Por më parë m'i thirr një herë të gjithë nëpunësat! — Shtoi drejtori dhe u ul në karrige duke përshpëritur «Ja ç'do të thotë të jesh i ndërgjegjshëm».

— Ju thirra t'ju vë në dijeni për një akt të lartë e të ndërgjegjshëm të shefit tuaj. Të tillë duhet të jenë nëpunësat, të vënë interesat e ndërmarrjes mbi interesat personale. Shoku Kajrafil anulloi lejen, dorëzoi edhe vilën që e ka siguruar me mik, la mënjanë qejfin dhe dëfrimin për t'u mbytur nëpër dosjet e seksionit. Te Kajrafil ju duhet ta shikoni veten si në pasqyrë. Del pyetja: Pse e bën këtë Kajrafil? Se ju, si nëpunësat e tij që jeni, nuk e ndihmoni, nuk jeni në gjendje të kryeni as detyrën për të cilën paguheni. Formularët që do të bëjë Kajrafil, ju ta-kojnë juve, por...

Ndërsa drejtori vazhdonte të fliste, Kajrafil i qeshte buza dhe ndofta për «modesti» qëndronte kokulur. Kishte hapur sirtarin e, për ta treguar veten se diç kërkonte, trazonte letrat në thellësi të sirtarit. Sytë i shkuan te buletini dhe u trondit. Në moment u step. Pamja e tij i ngjante një mumje.

Drejtori vazhdonte të fliste. Kajrafil vazhdonte

të skuqej e pak më vonë ngjyra e faqeve nga e kuqe filloi të kthehej në blu të errët. Lotët filluan t'i pikonin mbi tryezë dhe djersa ja mbuloi fytyrën.

Drejtori u habit. Ndërsa ne qeshëm.

— Çfarë keni, Kajrafil? — E pyeti i shqetësuar drejtori.

Heshtjen e theu zilja e telefonit. Kajrafil e mori me përtesë.

— U ur-dhë-ro! — Foli ai duke nxjerrë me zor fjalët.

— E prenotove maqinën për në plazh? — Kumboi i gëzuar në zyrë zëri i Manushaqes.

— Mua ma anulloi lejen drejtori... — Foli shefi dhe receptori i shpëtoi nga dora. Drejtori shtangu i habitur. Ne qeshëm me të madhe.

— Ç'është ky qëndrim dyfytyrësh, Kajrafil?! — Pyeti drejtori i habitur.

Heshtje...

— Më falni, shoku drejtor. — Theu heshtjen Donika duke i afruar një dosje drejtorit.

— Çfarë? — Pyeti drejtori që ende e kishte të paqartë shfaqjen e kësaj komedie që zhvillohej në orarin zyrtar.

— Ju lutem firmoni këta formularë, se nesër duhet të jenë në dikaster. Ja, i keni gati. — Foli Donika dhe i zgjati stilografin drejtorit.

Drejtori ktheu kokën të shikonte shefin, por ai ishte lëshuar i tëri në karrige. I kishte rënë të fikët.

KUR TË VRET NDËRGJEGJA NË MES TË RRUGËS

Autobusi qëndroi te sheshi.

Shoferi hapi portat dhe zbriti bashkë me pasagjerët. Pasi kontrolloi gjendjen e gomave, shoferi mori një kovë në dorë dhe shkoi lart te çesma, rreth së cilës çdo mbrëmje grumbullohen fshatarë e bëjnë një si pazar të vogël, ku shesin qengja, keca, pula e ndonjëherë edhe pemë.

Kishim hipur të gjithë lart në autobus dhe, të ngjitur trup në trup njëri me tjetrin prisnim me padurim shoferin, i cili ende ndodhej te fshatarët. Pas pak atje shkoi edhe faturinua. Ajo, sapo mbërriti aty, filloi të takohej e të bisedonte me ca fshatare, pastaj u shoqërua me njerën prej tyre dhe e solli në autobus. Të dyja bashkë mbanin një trastë. Kur hipën në autobus, faturinua e uli fshataren në vendin e vet.

Nuk po duronim dot më se vapa e kishte nxehur aq shumë autobusin, sa qëndrimi në të ishte mjaft i lodhshëm. I vetmi mjet që na josite në këto raste për të shtuar durimin e për të pritur shoferin ishte loja jonë me lepurin që solli Dëfrimi. Ja kishte dhuruar një fshatar.

— Ulu këtu, se je me fëmijë! — I tha Anastasia

Dëfrimit. Ai u ul bashkë me lepurin. Ne ju afruam dhe filluam të luanim me të, mu sikur të ishim fëmijë.

Kaluan minuta. U mërzitëm. Hapëm sytë nga dritaret për të hetuar se ku ndodhej e me çfarë po merrej shoferi. Po çfarë të shikonim? Shoferi ishte shtruar të bënte pazar me fshatarët. Merrte nëpër duar keca e qengja, i peshonte, pyeste për çmimin dhe, kur nuk i shkonte për shtat çmimi i atij të parit, lente atë e merrte një tjetër. Kjo punë vazhdoi për një kohë të gjatë. Ndofta mund të kishte më se një orë që shoferi bënte pazarllëk me fshatarët. Dikur i thirrëm:

— Ore shofer, a ke ndër mend të vish sonte apo... Hajde, more xhani i vëllait, se plasëm nga vapa, hall dita që kemi punuar pa e humbur minutën, po kjo e tanishmja po na lodh sa për pesë norma...

Ne thërrisnim e bërtisnim me të madhe, por shoferi nuk na e vinte fare në kandar fjalën. Shikoi njëherë nga ne dhe pëshpëriti: — Keni nge për muhabete ju, ore djema...

Ndofta do të ishim grindur keq me shoferin, por në autobus plasi shamata me faturinon. Kështu e kanë marrëveshjen e tyre faturinua me shoferin. Saherë që faturinua dikton se shoferi po kapet në gabim, i del zot. E, kur kapet faturinua, sikur edhe me pasagjerë pa biletë, hidhet në mbrojtje shoferi. Çfarë aleance e mrekullueshme!

— Ai që ka lepurin të zbrësë poshtë! — urdhëroi me ton të prerë faturinua.

— Pse? — Pyeti i habitur Dëfrimi.

— Është e ndaluar të transportohen kafshë dhe shpend me autobus.

— Kjo është kafshë e butë, moj shoqe, bile më e buta ndër kafshët, askujt nuk i kanoset lepuri dhe askush nuk trembet prej tij. — Folëm ne për ta mbrojtur shokun tonë.

— Vetëm bretkosat tremben nga lepuri, moj shoqe. — Foli Anastasia e cila në të vërtetë kishte pëshitur ta prekte.

— Rregullorja nuk i ndan të egra e të buta. Ajo i ndalon pasagjerët të transportojnë kafshë me autobus dhe pikë. Urbani është për njerëz e jo për kafshë. Ku keni parë ju të udhëtojnë njerëz e kafshë bashkë? Hajde, shok, zbrit poshtë e mos e zgjat shumë, se po na pengon në kryerjen e detyrës! — Bërtiti faturinua aq shumë, sa ne e pamë të udhës të mos flisnim më.

Ndofta faturinua do të kishte vazhduar të bërtiste akoma por lëkundja e autobusit, që paralajmëroi nisjen për rrugë, e ndërpreu grindjen tonë.

Lëkundja e parë qe e fortë. Faturinua, që ishte afruar te Dëfrimi, e humbi ekuilibrin dhe u gjend buzë më buzë me lepurin. Plasi e qeshura. Faturinua e pështyu lepurin e bashkë me të edhe Dëfrimin.

Lepuri nxori gjuhën e lëpiu buzët e mustaqet duke i pastruar nga pështyma e faturinës.

— Pasagjerë të pakulturë, a lejohet kjo që më bëni ju? — Bërtiti ajo dhe ju shkreh Dëfrimit. . .

— E ke mësuar lepurin të më përqeshë mua.

— Jo, s'është e vërtetë. — Foli më habi Dëfrimi duke fshirë djersët.

— Atëhere lepuri pse nxjerr gjuhën?

Ne krijuam bindjen se kishim të bënim me një faturinë që e kryente me rigorozitet të plotë detyrën prandaj, duke quajtur fajtor Dëfrimin, ju lutëm faturinës:

— Lëre, moj, lëre, ne po lozim me lepurin, qenka lepur i bukur. . . Por ajo nuk donte t'ja dinte për fjalët tona.

— Ju lutem, shokë, këtu pyetem unë e jo ju! Prandaj mos ndërhyjni në punën time. . .

— Mos bëni zhurmë andej nga fundi! — Bërtiti me sa fuqi kishte shoferi pa e kthyer kokën të shikonte se ç'bëhej. Tashmë u hodh ai në mbrojtje të faturinës.

— Autobusi kishte marrë shpejtësinë e zakonshme.

— Faturinua kërkoi ndihmën e shoferit, por ne i jepnim kurajo: — Forca shoferi, forca shoferi. . .

— Koç! — Mbaje maqinën, se ka hipur një pasagjer me lepur. . .

STOP! Autobusi qëndroi në vend. Shoferi u kthye nga ne dhe tha:

— Ai që ka lepurin të zbrësë poshtë!

— Fale, fale se e ka lepurin të butë. . . — Ju lutëm ne.

— Nuk lë unë patentën për lepujt tuaj! — Foli shoferi. — A e dini se është e ndaluar? Edhe ju nuk duhet të bëni gjëra që nuk lejohen. — Shtoi ai.

Kuptohej që ishte e kotë ndërhyrja jonë. Dëfrimi e pa të udhës që më mirë ta hidhte lepurin në ato drizat anës rrugës se sa të zbriste vetë me gjithë lepur. Këtë vendim e mori për të mos vënë shoferin në pozita që nuk lejohen. Bëri të ngrihej e të hidhte lepurin por ajo vajza që e kishte në duar e lëshoi. Lepuri vrapoi nëpër këmbët tona dhe u afrua te vendi i faturinës. Ndofta edhe ai e kishte kuptuar se ishte i tepërt në autobus dhe deshi t'i kërkonte falje faturinës e t'i lutej ta lejonte të udhëtonte edhe ai një herë në autobus, por fatkeqësisht nuk arriti as

të hapte gojën. Në vendin e faturinës ndodhej fshatarja me trastën përpara; kur u afrua lepurit te froni i saj, trasta u tund dhe prej saj doli një qen i madh mu sa një ujk. E kishte ndjerë erën e lepurit dhe kishte pritur çastin e volitshëm që ai t'i afrohej. Qeni, me të dalë nga trasta, e rroku lepurin mu në grykë. Kjo ishte përgjigja e faturinës që do t'i jepte lepurit.

I shkreti lepur çfarë hoqi! Lëshoi një klithmë të çjerrë, saqë edhe tani, kur e kujtoj, më rrëqethet trupi. Shoferi e dëgjoi klithmën dhe shpejt frenoi autobusin. Diç shikoi me vërejtje prapa sediles së tij dhe vrapoi drejt nesh por rruga ishte e zënë. Zgjodhi një variant tjetër: doli andej nga hyjnë pasagjerët. Derisa mbërriti shoferi te vendi i ngjarjes, qeni desh e shqeu lepurin. Fshatarja mundohej me të gjitha fuqitë ta hiqte lepurin nga goja e qenit, por nuk mundte. Faturinua nuk fliste fare, dikur filluan t'i dilnin edhe pika loti nga sytë.


Ne kujtuam se i vinte gjynah për lepurin, por ishte diçka tjetër që e bënte të qante.

U habitëm.

Me ndihmën tonë dhe të fshatares lepurit shpëtoi nga thonjtë e qenit dhe vrapoi nëpër këmbët tona drejt vendit të shoferit. Ndofta donte të denonconte te shoferi, duke paditur faturinën se, prej vendit ku rrin ajo doli një qen i strehuar në trastën e fshatares. Por këtu ndodhi pika më dramatike e gjithë ngjarjes: nëpër këmbët tona kaloj lepurit duke na lëmuar me leshin e tij të butë e fill pas kësaj vrapoi qeni duke na ngulur thonjtë e tij të fortë. Kërkonte të kishte rrugë të lirë i uruari qen dhe desh na shqeu të gjithë më keq se lepurin. Hamhamet e tij e dridhën gjithë autobusin. Por lepurit kërceu në sedilen e shoferit dhe, kur pa se posti i tij ndodhej bosh

e dera ishte hapur, përfitoi nga rasti dhe u hodh në rrugë, ndërsa qeni ende nuk kishte mbërritur te vendi i shoferit.

Kur ju afrua sediles së shoferit, qeni filloi të lihte me të madhe se e pa lepurin kur mori të për-pjetën nëpër drizat. Nga hamhamet e forta të qenit,



prapa sediles së shoferit u tund një trastë tjetër. Dig u tremb. Dhe qeni në çast nuhati. E kafshoi trastën dhe e ngriti lart. Në moment nga trasta doli një zë i çjerrë dhe i zgjatur «meeee éééé mééééé, ééééé». Ne u habitëm! Kujtuam se zagari e kapi përsëri lepurin dhe bënim çudi si ishte e mundur të bërtiste lepurit si kec.

— Plaç, tyty, dydydy, hyhy, lëshoje, lëshoje! — Bërtiti me të madhe shoferi dhe vrapoi të ndante sherrin.

Meeee — ja zgjatej edhe më shumë, kur qeni filloi ta tundte trastën të nxirrte prej andej gjahun e tij të dytë, se ai i pari mori arratinë. Pa mbërritur shoferi te vendi i ngjarjes së dytë, nga porta e parë fluturoi një kec. Ai u hodh përjashta dhe mori të përpjetën, duke ndjekur lepurin këmbë pas këmbë. Qeni ju vu pas.

— O djema! kapeni, se më iku keci, që e bleva te fshatarët. — Bërtiti shoferi.

— Bëri mirë që iku, se nuk lejohet në autobus: — Foli me ironi Anastasia.

Ne filluam të qeshnim, sikur të kishim parë një cirk të gëzuar.

— Pse po qeshni, more harbutër, a nuk shikoni se më iku keci që e kam blerë njëmijë lekë? Ju u bëtë shkaktarë që më iku. O do ta kapni, o do ta paguani, ndryshe autobusi nuk lëviz nga vendi! — Dha vendim të prerë shoferi dhe erdhi drejt nesh për t'u sqaruar.

— Ti bërtite për një lepur, ndërsa vetë paske marrë kec. — Foli dikush.

— Nuk të pyeti njeri ty, more mistrec, rri urtë se këtu në autobus pyetem unë... — Foli me inat

shoferi, por nuk ja kishte ngenë të merrej shumë me këtë se kishte hallin e kecit.

Keci dhe lepuri u zhdukën lart nëpër kaçube të ndjekur nga qeni, ndërsa ne vazhdonim gjyqin.

— I kujt ishte lepuri? — Pyeti shoferi.

— Imi. — U përgjegj Dëfrimi.

— Ti ta paguash kecin, se ndryshe, ja këtu do të rrini gjithë ditën!

— Kecin nuk ta trembi lepuri por qeni. — Ja priti një tjetër.

— Po qeni i kujt ishte? — Pyeti përsëri shoferi.

— I faturinës. — U hodh e tha fshatarja.

— I faturinës? — Pyeti i habitur shoferi.

— Po. — Pohoi fshatarja.

— Si është e mundur të jetë futur qeni i faturinës në trastën tënde?

— Trasta është imja, por qenin ja solla asaj se ma kishte kërkuar.

— Fajin nuk e kishte qeni, ai po rrinte shumë urtë, por e tërboi lepuri. — Sqaroi Faturinua.

— Tamëm ashtu është, ti ke thyer rregulloren e qarkullimit dhe duhet të përgjigjesh! Nuk lejohet që pasagjerët të transportojnë kafshë! — Dha vendim të prerë shoferi dhe nuk e lëvizi prej vendit autobusin.

Ndofta do të ishim vonuar me orë të tëra në atë vend, po të mos kishte ardhur shpejt inspektori i kontrollit rrugor, i cili, sapo dëgjoji pohimet tona, i hoqi patentën shoferit.

— Si nuk ju vrau ndërgjegjia të flisnit një fjalë të mirë për mua? — foli shoferi.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Kur nuk ke nuhatje, mos merr zotime	3
Te stanet e lepujve	10
Ditëlindja e gjyshit	16
Mrekullia e mësuesit të zoologjisë	28
Influenzus	34
Sezoni i pushimeve dimërore	41
Tjegulla me birë	48
Kur fillon të shkrijë bora	56
Ju lutem, mos qeshni	64
Inxheksioni	73
Pse, kjo është tokë e re?	80
Të falem nderit usta!	86
Një puthje jo e zakonëshme	94
Metamorfoza e shokut Kajrafil	103
Kur të vret ndërgjegjeja në mes të udhës.	113